



Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

RAPORTI VJETOR I PUNËS

2024



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

Raporti Vjetori i Punës së Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2024

Prishtinë, Qershor 2025



Tabela e përmbajtjes

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.1	TË ARRITURAT, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT	5
1.2	INDIKATORËT E TREGUT	14
2.	KORNIZA LIGJORE	15
2.1	BAZA EKZISTUESE LIGJORE QË RREGULLON AUTORITETIN	15
2.2	PËRMIRËSIMI I BAZËS LIGJORE NË PERIUDHËN RAPORTUESE	16
2.3	VËSHTIRËSITË LIGJORE QË KA HASUR INSTITUCIONI NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË VET	17
3.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	19
3.1	MISIONI / VIZIONI	19
3.2	KOMPETENCAT E ARKEP	20
4.	FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI	23
4.1	ORGANIZIMI, VEPRIMTARITË, PERSONELI DHE NIVELI I PAGAVE	23
4.2	BORDI	24
4.2.1	Mandati	24
4.2.2	Kompetencat	24
4.3	EKZEKUTIVI	25
4.4	BURIMET NJERËZORE	26
4.5	ASETET	31
5.	AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	32
5.1	Përshkrimi i shkurtë dhe një krahasim së paku me tre vitet e fundit	32
5.1.1	Autorizimet e Përgjithshme	32
5.1.2	Implementimi i bartshmerise se numrave	33
5.1.4	Pjesmarrja në aktivitetet e BEREC-ut	34
5.1.5	Menaxhimi i resurseve të fundme – Spektri frekuencor	35
5.1.6	Menaxhimi i Resurseve Numerike	37
5.1.7	Monitorimi i kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike	39
5.1.8	Analiza e tregjeve relevante, implementimi i detyrimeve rregullatore dhe mekanizmave për sigurimin e konkurrencës efektive	46
5.1.9	Mbrojtja e të drejtave të Konsumatorit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes operatorëve	47
5.1.10	Monitorimi i spektrit radio frekuencor dhe Inspektimi	49
5.1.11	Veprimtaria e Njërive teknike KOS-IX dhe KOS-CERT	50
	Njësia nacionale për siguri kibernetike KOS-CERT	53
5.1.12	Indikatorët e tregut të komunikimeve elektronike	54
5.1.13	Tregu i Telefonisë Mobile	55
5.1.17	Tregu i shërbimeve postare	61



5.1.18	Realizimi i planit të prokurimit.....	62
5.2	PLANET PËR VITIN VIJUES	62
5.2.1	Departamenti i Komunikimeve Elektronike	62
5.2.2	Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave	63
5.2.3	Departamenti i Radio Monitorimit dhe Inspektimit	63
5.2.5	Departamenti i Rregullimit Ekonomik dhe Tregut	63
5.2.6	Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve dhe Inspektimit.....	63
5.2.7	Divizioni i Teknologjisë së Informacionit	64
5.2.8	Njësia nacionale për reagime kibernetike KOS-CERT	66
5.2.9	Departamenti i Financave dhe shërbimeve të përgjithshme	66
5.2.10	Njesia e prokurimit	67
5.3	VEPRIMET QË KA NDËRMARRË INSTITUCIONI QË TË PËRMIRËSOHET/MONITOROHET TREGU/FUSHA E VEPRIMIT	67
5.4	SFIDAT E VITIT PARAPRAK.....	68
6.	REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)	69
6.1	DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KONFORM LIGJIT	70
6.2	QËLLIMET E ARRITURA NGA VITI PARAPRAK.....	70
7.	RAPORTI FINANCIAR.....	72
7.1	RAPORTI FINANCIAR.....	72
7.1.1	Të hyrat	72
7.1.2	Realizimi i Buxhetit	73
7.2	ADRESIMI I GJETJEVE TË AUDITORIT NGA VITET PARAPRAKE	74
8.	RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM ..	75
9.	SHTOJCA.....	76

**ARKEP**AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONISKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS20 Vjet besim, transparencë, përkushtim për një të ardhme
të sigurt dhe shoqëri të lidhur

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 TË ARRITURAT, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2024, ofron të dhëna mbi të arriturat e deritashme dhe angazhimeve të Autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara me Ligjet përkatëse në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Raporti paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për vitin 2024, në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në këta sektor. Ndërsa në pjesën e fundit të raportit është paraqitur raporti financiar (*Pika 7*) i Autoritetit, për vitin 2024, së bashku me raportin e Auditorit (*Pika 8*).

Aktivitetet e Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*shkurt: ARKEP ose Autoriteti*) gjatë vitit 2024, janë përqëndruar kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve si një nga parakushtet thelbësore për nxitjen e investimeve, sigurimin e cilësisë së duhur të ofrimit të shërbimeve dhe me çmime sa më të arsyeshme, oferta të ndryshme dhe konkurruese për përdoruesit fundor (*konsumatorët*) gjithnjë duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizës rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2024, është ballafaquar me sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë: pavaresia financiare, numri shumë i vogël i resurseve profesionale në dispozicion dhe nevoja e domosdoshme për rritjen e mëtutjeshme, interesim i ulët i të rinjve për t'u punësuar si pasojë e nivelit të ulët të pagave të atakuar nga niveli ndjeshëm më i lartë i pagave në sektorët që i rregullon dhe mbikëqyr dhe vlerësimit të tyre si kuadro atraktive dhe deficitare për tregun.

Të arriturat kryesore të Autoriteti për gjatë vitit 2024 ndër të tjera janë:

Rritja e efikasitetit në menaxhimin e resurseve frekuencore:

- Miratimi i **“Plani i Përdorimit të Radio frekuencave”** (Nr. Prot. 008/B/25 dt. , Vendimin nr. 2418 (nr. Prot. 007/B/25) të ARKEP;

Plani i përdorimit të radiofrekuencave në Republikën e Kosovës përcakton kushtet dhe mënyrën e përdorimit të radiofrekuencave për të gjitha brezet frekuencore të shërbimeve mobile IMT në shtrirjen e rrjetave MFCN në harmonizim me rekomandimet me të reja Evropiane të ECC/CEPT si dhe standardeve të ETSI për këto breze. Përditësimi i planifikimit i brezve frekuencor për shërbime fikse MW PtP nga 1 GHz deri 86 GHz,

- Miratimi i **“Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 694 - 790 MHz për rrjetat e komunikimeve të lëvizshme & fikse (MFCN)”** (Ref. dok.. Nr. Proto. 012/B/24)

Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 694-790 MHz, për rrjetat e komunikimeve të lëvizshme & fikse (MFCN)” përcakton shpërndarjen e brezit të frekuencave 694-790 MHz (“brezi 700 MHz”) për shërbimin e lëvizshëm të radio komunikimit, ndarja e brezit në radio kanale të frekuencave, detajet e hollësishme teknike, mënyra e shfrytëzimit, si dhe mënyra e dhënies së radio frekuencave për rrjetat e shërbimeve mobile MFCN (Mobile/Fixed Communications Networks). Shfrytësimi i resurseve frekuencore të këtij brezi mundësojnë avancimin e shërbimeve mobile IMT, në zbatim të teknologjisë 5G, prandaj janë të nevojshme për operatorët në shtrirjen e rrjetave MFCN të teknologjisë 5G në tërë territorin e vendit.

- Vlerësimi i çmimit të brezit 700 MHz dhe 2100 MHz për shërbime Mobile IMT në kushtet e reja të tregut si dhe inicimi i fazës së parë për dhënien e brezeve 2100 MHz dhe 700 MHz. Në kuadër të këtij procesi konform procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi, janë pranuar, shqyrtuar dhe publikuar shprehjet e interesit të operatorëve për brezet këto breze.
- Gjatë vitit 2024 janë lëshura dy (2) Autorizime të reja për shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezet 3710- 3800 MHz, në rrjetat Lokale me qëllim të hulumtimeve, inovacioneve dhe trajnimeve në zhvillimin e teknologjisë 5G.
- ARKEP në vitin 2024 ka mbajtur takime ndërmjet ARKEP dhe KPM dhe një takim i përbashkët me operatorë të TV transmetuesve Radio difuziv që shfrytëzojnë kanale frekuencor në brezin 700 MHz. Diskutimet janë fokusuar në shqyrtimin e mundësive për lirimin e brezit 700 MHz

nga TV transmetuesit Radio difuzive dhe te dy institucionet kane pikëpamje dhe harmonizim te përbashkët qe brezi 700 MHz ne rangun frekuencor 694- 790 MHz duhet te lirohet sa me pare nga ofruesit e shërbime radio difuzive gjegjësisht nga TV transmetuesit Radio difuzive dhe te mundësohet ARKEP fillimin e procesit për planifikimin, ndarjen dhe dhënien ne shfrytëzim te kapaciteteve frekuencore ne këtë brez për shërbime mobile IMT te rrjetave publike MFCN për Operatorë te telefonisë mobile.

- Janë zhvilluar procedurat ne shqyrtimin e kërkesave dhe aplikacioneve te Operatorëve për resurse Frekuencorë ne brezet 700 dhe 2100 MHz. Janë zhvilluar aktivitet njoftimi dhe konsultimi me palët e interesi - Operatoret e autorizuar për ofrimin e shërbime mobile publike të rrjetave MFCN me qellim te përmbylljes se procesit për dhënien e te drejtës se shfrytëzimit te kapaciteteve frekuencore në brezin 2100 MHz dhe 700 MHz të planifikuara dhe përcaktuara për shtrirjen e rrjetave publike mobile MFCN që ndikojnë në rritjen e kualitetin të shërbimeve mobile IMT/MFCN ne nivel vendi. Ky aktivitet është në proces e sipër dhe prite të përmbyllet ne tremujorin e pare te vitit 2025.
- Është iniciuar rishikimi i tarifave vjetore për mbikëqyrje dhe të drejtën e përdorimit të radio frekuencave me plotësim-ndryshmin e rregullores Nr. 57 me theks te veçantë rishikimin e tarifave për brezet frekuencore ne shfrytëzim për shërbime mobile IMT/MFCN me qëllim të nxitjes operatoreve për marrjen e kapaciteteve te reja frekuencore ne brezin 2100 MHz dhe 700 MHz qe ndikojnë ne rritje e kualitetit të shërbimeve mobile dhe mbulimin e zonave rurale me kualitet me te larte te shërbimeve mobile te rrjetave publike MFCN dhe ky aktivitet pritet te finalizohet ne tremujorin pare te vitit 2025.

ARKEP gjatë vitit 2024 si objektive kryesore ka pasur fuqizimin e mëtutjeshëm të drejtave të konsumatorëve (Konsumatori në qendër). Në veçanti, rregullat e reja të miratuara nga ARKEP konsistojnë në:

- Vendosjen e obligimeve shtesë për operatorët sa i përket rritjes së transparencës dhe informimit të konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre;
- Vendosjen e kërkesave specifike sa i përket kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, me fokus në shërbimet e qasjes në internet dhe kualitetin e shërbimit të thirrjeve me zë;
- Ofrimin e mundësisë për konsumatorët për ndërprerjen e kontratës, për rastin e pakove të kombinuara, atëherë kur ka ndryshim për cilindo element të pakos. Në rast të ndryshimeve në kushtet e kontratës për qasje në shërbimet mediale audio vizuale, konstatimet do t'i jap autoriteti kompetent – Komisioni i Pavarur për Media (KPM);
- Përcaktimin e procedurës për paraqitjen e ankesave, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mënyrës së kompensimit.

Për të mbikëqyrur përmbushjen e obligimeve të parapara me rregullat e reja të miratuara, ARKEP ka themeluar një departament të veçantë, i cili do të merret me mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Në vitin 2024, janë realizuar disa aktivitete të rëndësishme për implementimin e bartshmërisë së numrave:

- **Caktimi i numrave të rutimit**

Një nga hapat kryesorë për zbatimin e bartshmërisë së numrave ka qenë caktimi i numrave të rutimit për operatorët kryesorë të shërbimeve telekomunikuese në Kosovë, Telekom i Kosovës sh. a dhe IPKO.

- **Dhënia e Autorizimit për Bartshmërinë e Numrave për konsorciumin Botek shpk dhe PXS B.V.**

Në vitin 2024, është dhënë autorizimi për implementimin e bartshmërisë së numrave për konsorciumin Botek shpk dhe PXS B.V. Ky autorizim është një hap i rëndësishëm për realizimin e projektit, duke siguruar që proceset e bartjes së numrave të bëhen në mënyrë të sigurtë dhe efikase për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

- **Finalizimi i dokumentit “Kosovo Local (Mobile & Fixed) Number Portability Ordering Process Specifications (“LNP Business Rules”)**

Grupi Punues për Bartshmërinë e Numrave ka finalizuar dokumentin “Kosovo Local (Mobile & Fixed) Number Portability Ordering Process Specifications,” i cili përfshin rregullat dhe procedurat për bartshmërinë e numrave për shërbimet mobile dhe fikse. Ky dokument ka shërbyer si udhëzues për operatorët dhe për konsorciumin, duke siguruar që procesi të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të ofrojë një shërbim cilësor për konsumatorët.

- **Nënshkrimi i kontratës në mes operatorëve dhe PXS&Botek për implementimin e Bartshmërisë së numrave**

Një arritje tjetër e rëndësishme ka qenë nënshkrimi i kontratës në mes operatorëve Telekom i Kosovës dhe IPKO me konsorciumin PXS dhe Botek. Ky hap ka mundësuar fillimin e implementimit praktik të bartshmërisë së numrave, realizimin e testeve, etj.

- **Avansimi i mëtutjeshëm në rritjen e numrit të matjeve, transparencës, obligimeve për operatorët, sa i përket të parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.**

- Hartimi i Planit për matjen e parametrave të QoS për vitin 2024;
- Hartimi i udhëzuesve për konsumatorët lidhur me monitorimin e parametrave të kualitetit, parashtrimin e ankesave, si dhe zbatimin e rregullave të reja të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Aktivitetet tjera

Gjatë vitit 2024 janë miratuar Rregulloret si në vijim:

- Rregullorja Nr. 61 - për kontratat, transparencën, publikim e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundor të shërbimeve të KE-së,
- Rregullorja Nr. 62 - për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 50 për Planin e Numeracionit
- Rregullorja Nr. 63 - për Monitorimin e Parametrave të Kualitetit të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike,
- Rregullorja Nr.64 - për Dhënien e Autorizimit Individual për Radio Stacionet e Mjetit Ajror.
- Rregullorja Nr. 65 - për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.62 për Planin e Numeracionit,
- Rregullorja Nr. 66 - për Brezet Frekuencore dhe Kushtet Teknike për Shfrytëzimin e Pajisjeve për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual i Radio Frekuencave.

Ndërsa janë hartuar dhe pritët miratimi gjat vitit në vijim;

- Rregullorja për autorizimet e përgjithshme;
- Draft Rregullore mbi Sigurinë dhe funksionimin e duhur të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike.
- Janë realizuar inspekte të ndryshme të operatorëve për verifikimin e përmbuidhjes së obligimeve rregullatore dhe lidhur me gjetjet operatorët janë udhëzuar për marrjen e hapave për adresimin e tyre.
- Janë zvogluar në mënyrë të konsiderueshme tarifat vjetore për resurse numerike.
- Granti i fituar për KOSIX, për modernizimin dhe avancimin e shërbimeve në Nyjën Shkëmbyese të Internetit (KOSIX),
- Ka përfunduar analiza e tregjeve të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike, ku ARKEP ka përcaktuar operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT) siç janë: Telekom i Kosovës, IPKO dhe mts D.O.O. Me këtë rast janë vendosur kufijtë (cmimi tavan) për MTR dhe FTR si në vijim:
 - MTR: 1 Korrik 2024 -0.664 eurocent; 1 Korrik 2025 -0.564 eurocent; dhe 1 Korrik 2026 - 0.465 eurocent.
 - FTR: 1 Korrik 2024 -0.33 eurocent; 1 Korrik 2025 -0.23 eurocent; dhe 1 Korrik 2026 -0.13 eurocent.
- Gjatë kësaj periudhe janë pranuar rreth treqind e tetëdhjetë e pesë (385) ankesa nga përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe për shërbimet postare, ndër të cilat dyqind e tridhjet e një (231) ankesa për ofrimin e shërbimeve të internetit dhe kushtet e kontratave, njëqind e dymbëdhjetë (112) për shërbime të telefonisë mobile, tridhjetë e gjashtë (36) për kualitetin të shërbimeve të internetit, katër (4) ankesa për shërbimet postare, etj.

- Gjatë vitit 2024:
 - ARKEP më datë 18 Tetor 2024 ka lëshuar autorizimin e përgjithshëm për kompaninë Starlink, një lider global për ofrimin e shërbimeve satelitore të qasjes në internet. Ky autorizim përfaqëson një hap të rëndësishëm për avansimin e infrastrukturës digjitale në vend dhe ofron mundësi të shumta për ofrimin e qasjes në internet në çdo lokacion të territorit të Republikës së Kosovës.
 - Janë nxjerr mbi tetëdhjetë (80) Vendime për resurse numerike;
 - Gjashtëmbëdhjet (16) autorizime të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, përkatësisht u janë revokuar autorizimet katër (4) ndërmarrjeve;
 - Janë përgatitur dhe lëshuar njëqind e katër dhjetë e gjashtë (146) Autorizime Individuale të Radio frekuencave me ç ‘rast dhjetë (10) janë autorizime të reja. Prej tyre nëntëdhjetë e dy (92) Autorizime për shërbimin PMR, njëzet e nëntë (29) Autorizime për shërbimin Fiks, pesë (5) Autorizime për shërbimin Aeronautike si dhe katër (4) Autorizime për shërbimin satelitor. Në kuadër të autorizimeve të dhëna gjatë kësaj periudhe vetëm për KFOR-in, janë dhënë nëntëmbëdhjetë (19) Autorizime Individuale me gjithsejtë gjashtëdhjetë e pesë (65) kanale frekuencore të brezit civil që do të përdorën për qëllime militare. Gjithashtu është kërkuar nga KFOR-i përdorimi i njëqind e njëzet e katër (124) kanaleve frekuencore te brezit ushtarak për qëllime civile.
 - Janë lëshuar gjithsejt shtatë (7) licenca për Radio amatorë prej tyre pese (5) Licenca për radio amatore ndërkombëtare nga vendet Evropiane dhe dy (2) licenca për radio amatorë vendor,
 - katër (4) Autorizime të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare.
- Janë realizuar gjashtëdhjet e dy (62) monitorime në terren për verifikimin e shfrytëzueshmërisë së brezeve frekuencore VHF, UHF për shërbimet Aeronautike dhe PMR, në brezin 900 MHz, 1800 dhe 2100 MHz, për teknologjitë 2G, 3G dhe 4G si dhe brezin SHF për linjat mikrovalore PtP.
- Janë publikuar katër (4) raporte të rregullta tremujore ‘Pasqyra e Tregut të Komunikimeve Elektronike’.
- Pjesmarrja në takimet e grupeve punuese të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare si:
 - Dhjetë grupe punuese të ekspertëve (WG dhe CN), të Trupës së Rregullatorëve Evropian për Komunikime Elektronike (BEREC);
 - Grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes rajonale të roamingut (RRA) dhe zbatimit të udhërrëfyesit për zvogëlimin e tarifave të roamingut në mes vendeve të Ballkanit Përendimor (BP) dhe Bashkimit Europian (BE);
 - Prezentimi në konferenca ndërkombëtare lidhur me zhvillimin e shërbimeve brezgjëra dhe implementimi i teknologjisë 5G;

- Si pjesë e grupit punues për infrastrukturë kritike, ARKEP ka marrë pjesë në të gjitha takimet, duke dhënë kontributin e saj në sektorin e komunikimeve elektronike si dhe të sigurisë kibernetike në nivel vendi.
- Janë mbajtur takime të rregullta në nën komitetin për tregti dhe shërbime - CEFTA, ku ARKEP ka dhënë kontributin e tij në nxjerrjen e Vendimit të Komitetit të Përbashkët për shërbimet e dorëzimit të paketave ndërkufitare.

Në vitin 2024, nën moton **“20 vjet besim, transparencë, përkushtim për një të ardhme të sigurtë dhe shoqëri të lidhur”**, ARKEP festoi 20 - vjetorin e themelimit të tij, një jubile i rëndësishëm që pasqyron angazhimin e institucionit për zhvillimin e sektorit të komunikimeve dhe postës në Kosovë. Për të shënuar këtë arritje të rëndësishme, ARKEP organizoi një seri aktivitetsesh dhe ngjarjesh që nderuan punën e palodhshme të këtij institucioni gjatë dy dekadave të fundit. Gjatë këtij eventi, u theksua roli kyç i ARKEP në krijimin e një mjedisi të rregulluar dhe konkurrues për operatorët dhe konsumatorët, duke siguruar qasje në shërbime cilësore dhe të qëndrueshme. 20-vjetori shënoi një moment reflektimi për arritjet e realizuara, por edhe një mundësi për të diskutuar sfidat e ardhshme dhe për të vazhduar përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në sektorin e komunikimeve dhe postës në vend.

Për sa i përket të hyrave Autoriteti për vitin 2024, Autoriteti ka planifikuar të hyra në vlerën 7,486,490.00 Euro, ndërsa shuma e të hyrave të realizuar është 5,065,207.18 Euro, apo shprehur në përqindje rreth 67.66 %.

Në aspektin e avancimit të transparencës dhe llogaridhënies gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vazhduar ta përmbushë obligimin e saj lidhur me publikimin e punëve dhe angazhimeve të kryera. Të gjitha informacionet dhe dokumentet relevante mbi aktivitetet e Autoritetit janë publikuar rregullisht në ueb faqen e Autoritetit, përfshi këtu dhe jo vetëm;

- i. Publikimi i të gjitha akteve rregullatore dhe vendimeve me efekt rregullator të miratuara nga Bordi Drejtues, përfshi këtu edhe vendimet administrative me efekt për palët e treta;
- ii. Zhvillimi i procedurave të këshillimit publik si të parapara me dispozitat e Ligjit, ku janë organizuar dhe mbajtur seanca të këshillimeve mbi të gjitha çështjet me rëndësi për palët e interesit;
- iii. Publikimi dhe azhurnimi i rregullt i bazës së të dhënave, gjegjësisht regjistrave të operatorëve, ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, operatorëve të shërbimeve postare, si dhe shfrytëzuesve të autorizuar të resurseve/kanaleve frekuencore dhe numerike;
- iv. Publikimi i rregullt i raporteve periodike me të dhënat statistikore të tregjeve të komunikimeve elektronike dhe postare;
- v. Publikimin e rregullt të të dhënave dhe informacioneve për shfrytëzuesit e fundmë (konsumatorët) e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare;

Për më tepër, zyrtarët drejtues të Autoritetit kanë qenë të hapur ndaj mediave audio-vizuele dhe të shkruara, ku në mënyrë dhe kohë reale i janë përgjigjur kërkesave të ndryshme të mediave dhe kanë informuar audiencën e gjerë mbi të gjitha çështjet e vlerësuara me rëndësi për/dhe mbi lëmin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Gjithsesi, në referim të përmbushjes së obligimeve për transparencë, vlen të theksohet se në mungesë të resurseve njerëzore dhe profesionale, edhe gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vazhduar të përballet me sfida të ndryshme administrative, ndërlidhur me obligimin për publikimin e dokumenteve edhe në gjuhën serbe dhe atë angleze.

Sa i përket planit të performancës për vitin 2024, ARKEP, ka pasur për qëllim t'i adresojë objektivat rregullatore të përcaktuara me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Ligjin për Uljen e Kostos për Shtrirjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike dhe Ligjin për Shërbimet Postare.

NË VEÇANTI OBJEKTIVAT ME FOKUS TË PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2024 ISHIN:

- (a) Sigurimin e krijimit të kornizës rregullatore, e cila është në hap me kohën dhe i adreson nevojat e tregut, promovon inovacionin gjithnjë duke i ruajtur interes publike të vendit;**
- (b) Promovimin e mëtutjeshëm të shtrirjes së rrjetave të kapacitetit të lartë (VHCN), duke përfshirë rrjetat 5G dhe ato të gjeneratave të ardhshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ofruar lidhje Gbps për të gjithë qytetarët;**
- (c) Krijimin e mekanizmave të përshtatshëm për ofrimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;**
- (d) Rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për të promovuar interesat e vendit dhe nxitur investimet në sektor;**
- (e) Antarësimin e mëtutjeshëm në Institucione dhe organizata ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.**
- (f) mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe**
- (g) forcimin e fleksibilitetit, pavarësisë, gjithëpërfshirjes dhe efikasitetit të ARKEP-it si një qendër e ekspertizës.**


OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË AUTORITETIT NË VITET NË VIJIM DO TË JENË:

Figura 1. Orientimi strategjik i Autoritetit

ORIENTIMI STRATEGJIK AFATËGJATË I AUTORITETIT:

- *Promovimi i shtrirjes së rrjetave dhe shërbimeve brez-gjëra me shpejtësi të lartë në tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe teknologjisë 5G;*
- *Promovimi i konektivitetit të plotë dhe cilësor në nivel vendi dhe bashkëshfrytëzimi i infrastrukturës;*
- *Sigurimi i konkurrencës së shëndoshë dhe inkurajimi i investimeve në sektor;*
- *Monitorimi i spektrit frekuencor përmes stacioneve fikse të Radio Monitorimit, në kuptim të mbulueshmerise në kohe dhe hapsirë në tërë territorin e Republikës se Kosovës;*
- *Sigurimi i pavarësisë së plotë financiare dhe rritja e efikasitetit rregullator.*

1.2 INDIKATORËT E TREGUT

Tregu i telefonisë mobile në vitin 2024, ka shënuar ulje të lehtë për sa i përket numrit të përdoruesve, ndërsa ka pasur rritje më të theksuar në të hyra. Të hyrat e përgjithshme nga shërbimet e telefonisë mobile në vitin 2024 janë rreth 125,528,885.00 milion euro, që paraqesin një rritje të konsiderueshme prej shtate (7) milionë euro, apo shprehur në përqindje rreth 6 %, më shumë në krahasim me vitin 2023.

Sa i përket përdoruesve, numri i përgjithshëm i përdoruesve aktivë të telefonisë mobile në fund të vitit 2024 është rreth 1,936,000, përderisa në vitin 2023, kjo shifër ishte 1,941.815 që krahasuar me fundin e vitit 2023, evidentohet ulje prej -0.30 %. Penetrimi në fund të vitit 2024 rezulton të jetë 120.81%.

Evoluimi i teknologjisë i referuar si konvergjenca teknologjike dhe sjelljet e përdoruesve si konsumatorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike në drejtim të shfrytëzimit të qasjes në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për zhvillimin e rrjetave fikse të jetë qasja broadband në Internet. Nga indikatorët dhe të dhënat nga pjesa e raportit të pasqyrës së tregut vërehet një maturim i këtij tregu pasi që numri i përdoruesve është përafërsisht i njëjtë me vitin 2023.

Në shumë raporte studimore, Kosova konsiderohet se është zhvilluar relativisht mirë në sektorin e komunikimeve elektronike. Një qëndrim i tillë vjen kur përmes indikatorësh të ndryshëm Kosova, krahasohet me vendet dhe regjione të tjera.

Shërbimet e internetit brezgjërë-qasja fikse janë shpërndarë gjithandej Kosovës, këtë e dëshmon shkalla e lartë e penetrimit për ekonomi familjare me 121%.

Sipas shtrirjes së teknologjisë së gjeneratës së ardhshme, ku vend kryesor zënë fibri optik (FTTX), Kosova e mulon popullsinë me vetëm 27%, është më së dobëti në rajon, pasi që vendet tjera e mbulojnë më mirë popullsinë me këtë teknologji, duke filluar me Shqipërinë me 60%, Mali i Zi me 48%, Serbia me 29.7% dhe Maqedonia me 29.4%. Në vendet e Bashkimit Evropian, 63.4% e popullsisë mbulohet me FTTH.

ARPU mobile në Kosovë është 5.4€/muaj, sa 1/3 e BE-së, që është 15€/muaj.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga Autoriteti, në vitin 2024, kemi pasur në total 6,021,061 dërgesa. Krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2023, që kishte 6,266,656 dërgesa, rezulton se kemi një renie të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën -3.92 %, përderisa 'Posta Kosovës' SHA, ka një rritje të volumit të dërgesave postare në vlerën 16.55 %, ndërsa operatorët privat kanë një renie në vlerën -18.77 %. 'Posta Kosovës' SHA, si operator publik postar mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare me 51.01 %, kurse operatorët privat janë të përfaqësuar në vlerën 48.99%, të tregut të përgjithshëm.



2. KORNIZA LIGJORE

2.1 BAZA EKZISTUESE LIGJORE QË RREGULLON AUTORITETIN

Autoriteti veprimtarinë e vet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare e bazon në përputhje me Legjislacionin e paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1. Baza ligjore

Legjislacioni Primar/Ligjet			
1	Ligji për Komunikimet Elektronike ¹	04/L-109	04 Tetor 2012
2	Ligji për Shërbimet Postare ²	06/L-038	21 Dhjetor 2018
3	Ligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjetave të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë	08/L-007	6 Dhjetor 2021

Deri në fund të vitit 2024, ARKEP ka miratuar një numër të konsiderueshëm të akteve nën ligjore, të rëndësishme për përmbushjen e objektivave rregullatore dhe obligimeve të dala nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA). Të gjitha aktet e miratuara deri në fund të vitit 2024 i gjeni në linkun; <https://www.arkep-rks.org/NewsEvent/9> ndërsa në *Shtojcën I*, të këtij raporti janë paraqitur përveç akteve ligjore edhe aktet nënligjore të miratuara në vitin 2024.

¹ Ky Ligj ka shfuqizuar Ligjin Nr.2002/7, mbi Telekomunikacionin,

² Ky Ligj ka shfuqizuar Ligjin Nr. 03/L-173, për shërbimet postare,

2.2 PËRMIRËSIMI I BAZËS LIGJORE NË PERIU DHËN RAPORTUESE

Në periudhën raportuese janë miratuar rregullore të reja si në vijim:

- **Rregullore Nr. 61 - për Kontratat, transparencën, publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike;**

Kjo Rregullore përcakton termat dhe kushtet, të cilat duhet t'i përmbajë kontrata për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, masat për rritjen e transparencës dhe publikimin e informatës në dobi të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, si dhe rregullat dhe procedurat e zgjidhjes së ankesave që mund të lindin nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë fundorë, në lidhje me kontratat.

- **Rregullore Nr. 62 - për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 50 Planit të Numeracionit;**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është definimi i Planit Kombëtar të Numeracionit, përcaktimit të strukturës, gjatësisë dhe procedurave për dhënien e numrave për qasje në rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike.

- **Rregullore Nr. 63 - për monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike;**

Kjo rregullore përcakton dhe detajon parametrat e kualitetit për shërbimet e komunikimeve elektronike të ofruara nga operatorët në tregun e shitjeve me pakicë, me theks parametrat e kualitetit për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet telefonike të zërit/thirrjeve, shërbimet e operatorit (*help-desk*), rregullat për deklarimin dhe raportimin e vlerave të parametrave të kualitetit të shërbimeve, kërkesat për matjet e parametrave, si dhe raportin vjetor të kualitetit të shërbimeve për publikim nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

- **Rregullore Nr. 64 - për dhënien e autorizimit individual për radio stacionet e Mjetit ajror**

Qëllimi i Rregullores është që përmes rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore të sigurohet ofrimi i shërbimit të radio stacioneve të mjetit ajror mbi bazën e një Autorizimi Individual të harmonizuar me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve) dhe me Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

- **Rregullore Nr. 65 - për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.62 për Planin e Numeracionit**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është definimi i Planit Kombëtar të Numeracionit, përcaktimit të strukturës, gjatësisë dhe procedurave për dhënien e numrave për qasje në rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike, ashtu që të:

- a) sigurojë strukturim dhe shfrytëzim efikas të numrave dhe serive të numrave;
- b) plotësojë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave;
- c) sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme, transparente dhe jo-diskriminuese;

○ Rregullore Nr. 66 - për Brezet Frekuencore dhe Kushtet Teknike për Shfrytëzimin e Pajisjeve për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual i Radio Frekuencave

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i rregullave për shfrytëzimin e resurseve frekuencore për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual për radio frekuenca si dhe definon kushtet të cilat duhet të përmbushen nga një radio pajisje gjatë përdorimit të tyre në brezat e frekuencave të përcaktuara në këtë rregullore.

Kjo Rregullore është në përputhje me dokumentet ndërkombëtare, Vendimet, Rekomandimet dhe Raportet Evropiane që planifikojnë, harmonizojnë dhe përcaktojnë shfrytëzimin efektiv dhe efikas të radio frekuencave.

2.3 VËSHTIRËSITË LIGJORE QË KA HASUR INSTITUCIONI NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË VET

ARKEP në vazhdimësi është duke u ballafaquar me sfida të shumta, por në veçanti po i përmendim dy çështje të cilat ndikojnë më së shumti në arritjen e objektivave të Autoritetit, e ato janë çështjet në vijim:

- Mungesa e pavarësisë financiare si rezultat i interpretimit të kufizuar të Ligjit për Menaxhimin e Financave, respektivisht procedurës së miratimit të Buxhetit;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale, me fokus të veçantë tek ruajtja dhe rritja e resurseve profesionale/nëpunësve të ARKEP;

Këto sfida janë adresuar në vazhdimësi edhe nga Bashkimi Evropian (BE) në të gjitha takimet e mbajtura në kuadër të nën-komitetit për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politikave sociale, dhe në të gjitha Raportet vjetore të Progresit të publikuara për Republikën e Kosovës.

Në veçanti, pagat për disa profile mbeten të ulëta dhe të pa krahasueshme me pagat e sektorit, të cilin ARKEP e rregullon. ARKEP vlerëson lartë Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për klasifikimin e disa pozitave të zyrtarëve të profilin inxhinier në kategorinë ekspert, që ka mundësuar krijimin e kushteve më të favorshme të punës për zyrtarët në fjalë. Megjithatë, marrë parasysh faktin se në ARKEP pothuajse asnjë aktivitet rregullator nuk zhvillohet dhe përmbyllet pa angazhimin edhe të profesioneve tjera si ekonomist dhe jurist, atëherë është kryesore dhe çështje urgjente që të gjendet një zgjidhje edhe për këta zyrtarë.

Për sa i përket mungesës së pavarësisë financiare, ARKEP ka vështirësi të mëdha në implementimin e projekteve të ndryshme dhe ruajtjen e stafit profesional. Në këtë kuptim duke iu referuar Ligjit Nr. 04/L-109, për Komunikime Elektronike, përkatësisht neni 8, paragrafi 2, i cili në mënyrë të qartë specifikon:

‘Autoriteti është person juridik, publik, vetë financues, jofitimprurës, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur’.

Ndërsa neni 81, paragrafi 1, i Ligjit specifikon; ‘Burimet e financimit të Autoritetit sigurohen nga Buxheti i Kosovës, përmes të hyrave të Autoritetit në pajtim me nenin 83 të këtij ligji’.

Pra bazuar në dispozitën e nenit 81, paragrafin 1, rezulton se në mënyrë të drejtpërdrejtë është e cenuar pavarësia financiare dhe funksionimi i Autoritetit gjë që është potencuar edhe nga raportet dhe rekomandimet e institucioneve të BE-së.

Pavarësia financiare e Autoritetit është kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Evropian në raportet për Kosovën. Raporti i fundit i vitit 2023 për Kosovën ndër të tjera thekson se:

‘resurset aktuale të ARKEP janë të kufizuara dhe nuk janë në proporcion me përgjegjësitë e tyre dhe njëherit kërkojnë nga institucionet që të sigurojnë burime të mjaftueshme për të përmbushur mandatin e tyre në mënyrë të pavarur’.

Pra ARKEP ende mbetet i kufizuar në aspekt të pavarësis së plotë finaciare ku si rezultat i saj ARKEP është i kufizuar në zbatim të plotë të politikave në komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe zbatim të plotë të direktivave evropiane.



3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 MISIONI / VIZIONI

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*shkurtë; ARKEP ose Autoriteti*), është themeluar si institucion i pavarur nga Kuvendi i Kosovës, sipas **nenit 142**, të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës**, që të ushtroj dhe kryen rregullimin ekonomik në sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, në pajtim me *Ligjin Nr. 04/L-109³, për Komunikimet Elektronike*, si dhe *Ligjin Nr. 06/L-038⁴, për Shërbimet Postare*, si dhe me qëllimi të lehtësimit dhe nxitjes së ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë zbaton gjithashtu edhe *Ligjin Nr. 08/L – 007⁵, për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë*.

ARKEP, është autoritet nacional rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimeve postare, i cili zbaton dhe mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar me ligjin për komunikimet elektronike, ligji për shërbimet postar si dhe politikat e sektorit.

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2851>

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18419>

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51135>

Autoriteti është person juridik, publik, vetëfinancues, jofitimprurës, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur. Autoriteti udhëhiqet dhe drejtohet nga Bordi i Autoritetit që është njëkohësisht autoriteti ligjor dhe i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*Ref. Nr. Prot. 054/B/17*), të miratuar nga ai vet. Kuvendi cakton Kryetarin ndërmjet anëtarëve të Bordit, i cili njëkohësisht është drejtues ekzekutiv i Autoritetit.



MISIONI

Misioni i Autoritetit është rregullimi i tregut të komunikimeve elektronike dhe postare duke krijuar kushte për një mjedis të favorshëm dhe të sigurtë për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, nxitjen e investimeve në njërën anë, dhe në anën tjetër t'u mundësohet përdoruesve fundor ofrimi i shërbimeve me cilësi dhe shpejtësi sa më të madhe të mundshme, në një afat kohor sa më të shpejtë, me siguri të lartë, si dhe me çmime të arsyeshme.



VIZIONI

Vizioni i Autoritetit është që të zhvillojë sektorin e Komunikimeve Elektronike në Kosovë, dhe ekonominë informative përmes implementimit të politikave që janë në përputhshmëri me reformat në këtë sektor të cilat implementohen nga Unioni Evropian dhe pjesa tjetër e botës së industrializuar. Ne do të arrijmë vizionin tonë përmes hyrjes në treg, promovimit të konkurrencës së shëndoshë midis operatorëve të autorizuar, teknologjive dhe shërbimeve të reja në mënyrë që të përmbushen kërkesat e konsumatorëve. Si ARKEP, do të sigurojmë mbrojtjen e konsumatorit, qeverisje të dobishme dhe transparente dhe përdorim optimal të resurseve të kufizuara.

3.2 KOMPETENCAT E ARKEP

Kompetencat dhe detyrat e Autoritetit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike (*tutje: LKE*) dhe Ligjin Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare (*tutje: LSHP*), si dhe Ligjin Nr. 08/L – 007, për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë.

Autoriteti ushtron funksionet e tij në përputhje me ligjet dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.

Kompetencat e ARKEP, në fushën e komunikimeve elektronike janë të percaktuara në nenin 10 të LKE:

- Në bashkëpunim me ministrinë përgatitë Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave;
- Mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore nga ndërmarrësit që kryejnë veprimtarinë e tyre në fushën e komunikimeve elektronike;
- Publikon çdo informacion të nevojshëm për zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues;
- Miraton legjislacionin sekondar lidhur me implementimin e ligjit për komunikimet elektronike, ligjit për shërbimet postare dhe strategjitë/politikat e miratuara nga Qeveria;
- Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu;
- Miraton vendimet lidhur me përcaktimin e ofruesve të shërbimeve universale dhe përcaktimin e obligimeve dhe të drejtave të tyre;
- Monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve;
- Zgjidhë mosmarrëveshjet, duke përfshirë ato që lidhen me çështjet e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe pasurive në mes të ndërmarrësve;
- Zgjidhë mosmarrëveshjet në mes të përdoruesve fundorë dhe operatorëve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- Monitoron dhe rregullon përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe pasurive;
- Miraton Planin Kombëtar të numeracionit, Planin për përdorimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit;
- Menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio-frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike;
- Zbaton detyrat që lidhen me kompatibilitetin elektromagnetik, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve, radio-monitorimin dhe eliminimin e Interferencave (*ndërrhyrjeve*) të Radios;
- Lëshon autorizime dhe akte të tjera në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit/ligjeve si dhe rregulloret e miratuara;
- Miraton vendimet lidhur me grantet, transferet dhe revokimin e licencave individuale për përdorimin e spektrit të radio-frekuencave në bazë të tenderit publik dhe procedurave të Ankandit publik;
- Kontribuon në përgatitjen e propozimeve të strategjive kombëtare dhe politikave;
- Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, bashkëpunon dhe participon në punën e organeve punuese administrative dhe ndërkombëtare, regjionale, si dhe organizatave dhe institucioneve në fushën e komunikimeve elektronike aty ku aderon Republika e Kosovës;
- Në bazë të autorizimeve të marra, lidhë marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në fushën e komunikimeve elektronike;
- Publikon informatat/udhërrëfyes lidhur me zbatimin e ligjit brenda fushës dhe duke iu nënshtruar procedurës dhe kushteve të vendosura nga vetë Autoriteti;
- Kryen funksionet e qendrës kompjuterike për reagime emergjente me qëllim të ballafaqimit me rreziqet për sistemet publike të komunikimeve elektronike;
- Bën konsultime lidhur me zbatimin e ligjit si dhe rregulloret e nxjerra nga Autoriteti.

Kompetencat e ARKEP, në fushën e shërbimeve postare janë të specifikuara në dispozitat e nenit 7 të LSHP, dhe atë si në vijim;

- harton dhe miraton rregulloret në zbatim të këtij ligji;
- lëshon dhe tërheq autorizimet, të dhëna në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore;
- përcakton ofruesin e shërbimit universal postar sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar;
- mbikëqyrë, monitoron dhe inspekton veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
- mbikëqyrë respektimin e kërkesave ligjore për tarifat e shërbimeve postare dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji;
- harton, kontrollon dhe mbikëqyrë standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit dhe shërbimit universal postar në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare;
- nxit konkurrencën e lirë ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare, për të garantuar transparencën dhe mos diskriminimin;
- mbledhë dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore, duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë;
- harton dhe miraton kushtet dhe termat e përgjithshëm të ofrimit të shërbimit universal postar;
- rregullon dhe miraton tarifat e shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera specifike, të përcaktuara me këtë ligj;
- zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimit postar;
- mbron të drejtat e shfrytëzuesve të shërbimeve postare dhe zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet shfrytëzuesve dhe ofruesve të shërbimeve postare;
- bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare;
- përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare rregullatore të shërbimeve postare.

Po ashtu ARKEP do të zbatojë edhe Ligjin Nr. 08/L – 007, për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë, ku me anë të këtij ligji ARKEP-it, i janë vendosur kompetenca shtesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast të refuzimit të qasjes në infrastrukturën ekzistuese fizike, si dhe kompetenca për shqiptimin e sanksioneve ekonomike në rast të mos zbatimit të këtij Ligji nga ana e operatorëve të rrjetit. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, ARKEP është në komunikim të sipër me Ministrinë e Ekonomisë për transferimin e kompetencave sa i përket krijimit të qendrës së vetme të informimit si dhe menaxhimit të atlasit elektronik për mapimin gjeografik të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.



4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

4.1 ORGANIZIMI, VEPRIMTARITË, PERSONELI DHE NIVELI I PAGAVE

Bordi i Autoritetit në vitin 2023 ka miratuar Rregulloren Nr. 59 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, përmes vendimit Nr. 2227 (Ref. Nr. Prot. 061/B/23) dhe ai paraqitet si më poshtë.

Autoriteti aktualisht ka të aprovuara dyzet e dy (42) pozita, përfshirë këtu edhe pesë (5) pozita të anëtarëve të Bordit, por se në strukturën e re organizative ka paraparë shtatëdhjetetë (73) pozita, pozita këto të cilat do të plotësohen konform kërkesave të cilat do të realizohen pas aprovimit nga Bordi i ARKEP dhe lejimeve buxhetore të aprovuara nga Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës.




Figura 2. Struktura Organizative e ARKEP-it

4.2 BORDI

Autoriteti drejtohet nga Bordi Drejtues i Autoritetit, i cili është organi më i lartë vendimmarrës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tij rregullatore. Bordi i Autoritetit përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, prej të cilëve njëri është Kryetari i Bordit.

4.2.1 Mandati

Kryetari dhe anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi me mandat pesë (5) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandatë tjetër. Bordi aktual është zgjedhur me Vendimin Nr.08-V-012, të datës; 27.05.2021, të Kuvendit të Kosovës. Anëtari i Bordit nuk mund të shërbejë më tepër se dy (2) mandate.

4.2.2 Kompetencat

Bordi i Autoritetit është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e veta vetëm në bazë të ligjit, politikave të Qeverisë, statutit dhe akteve tjera normative të miratuara nga Bordi.

Anëtarët e Bordit ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë sipas ligjit dhe statutit dhe në përputhje me standardet dhe praktikat menaxhuese ndërkombëtare që zbatohen për bordet drejtuese rregullatore. Anëtarët e Bordit ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, profesionalizmit, paanshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, konfidencialitetit dhe ndershmërisë.

4.3 EKZEKUTIVI

Përveç ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiave rregullatore si anëtar i Bordit, Kryetari i Bordit është udhëheqësi më i lart administrativ, përkatësisht Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Autoritetit, dhe është përgjegjës për administrimin e Autoritetit në pajtim me ligjin.

Menaxhmenti i mesëm

Bordi i Autoritetit mbështet nga menaxhmenti i mesëm të cilët janë shefat të departamenteve dhe udhëheqësit e njësive të Autoritetit të cilat menaxhojnë dikastere të veçanta brenda Autoritetit.

Njësiti funksionale rregullatore:

- Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE);
- Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (DMF);
- Departamenti i Monitorimit Radio Frekuencor (DMRF);
- Departamentit të Rregullimit Ekonomik të Tregut (DRRET)
- Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Inspektimit (DMKI)
- Departamenti Ligjor (DL);
- Divizioni i Teknologjisë së Informacionit (DTI);

Njësiti mbështetëse teknike:

- Qendra kompjuterike e reagimit emergjent KOS-CERT;

Njësiti mbështetëse Administrative:

- Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
- Njësia e Prokurimit;
- Njësia e Certifikimit.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Mandati

Autoriteti është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e gjitha aktiviteteve të komunikimeve elektronike dhe postare duke u mbështetur në parimet rregullatore, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike dhe postare si dhe duke garantuar shërbimet cilësore dhe të përshtatshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

4.4 BURIMET NJERËZORE

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në vitin raportues ka pasur të punësuar gjithsejtë tridhjetë e tetë (38) nënpunës civil, përfshirë këtu edhe pesë (5) pozita të Anëtarëve të Bordit, ndërsa të aprovuara ka patur gjithsejtë dyzet e dy (42) pozita.

Edhe për kundër tentimit të plotësimit të të gjitha pozitave të lira, gjatë vitit 2024, janë realizuar me sukses rekrutimet për gjashtë (6) pozita, janë rekrutuar me konkurs të hapur publik. Ndërsa janë në proces të rekrutim edhe dy (2) pozita të tjera të cilat për shkak të dështimit të konkurseve të brendshme nuk kemi arritur ti përmbyllim brenda vitit raportues.

Tabela 2. Numri i stafit të ARKEP

STAFI I AUTORITETIT	
Numri i përgjithshëm i stafit;	36 (Përfshirë Bordin e ARKEP)
Numri i përgjithshëm i personelit femra;	19
Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bordit;	4
Numri i përgjithshëm i shefave të Departamenteve	5
Numri i përgjithshëm i Udhëheqësve të zyrave	5
Numri i përgjithshëm i Femrave në menaxhimet të lartë (përfshirë Bordin);	3

Pra edhe gjatë vitit 2024 është vazhduar me procedurat për rekrutimin dhe plotësimin e pozitave të lira si në vijim:

1. Zyrtar/e i/e lartë për Statistika,
2. Zyrtar/e i/e lartë për mbikëqyrje,
3. Zyrtar/e i/e lartë për Siguri dhe Integritet të Rrjetave të Komunikimeve Elektronike,
4. Zyrtar/e i/e lartë për Shërbime dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare për Radio frekuenca.

Pozitat e shpalluar e të cilat janë në proces të rekrutimit janë:

1. Drejtor/e - Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Inspektimit.
2. Drejtor/e - Departamenti i Rregullimit Ekonomik të Tregut.

Për arsye të nivelit të pagave të ulëta numri i zyrtareve që kanë dhënë dorëheqje nga pozitat profesionale janë dy (2) si në vijim:

1. U.D. Drejtor – Departamenti i Rregullimi Ekonomik i Tregut, dhe
2. Analist i Sigurisë Kibernetike.

Duhet potencuar se ARKEP, ka plotësuar kërkesat ligjore në përfaqësimin dhe balancin e barazisë gjinore, ndërsa sfida mbetet punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo shqiptare, edhe pse vazhdimisht e kemi potencuar në konkurse se inkurajohet aplikimi nga pjesëtarët e minoriteteve, por asnjë nga minoritarët nuk ka aplikuar, kështu që në institucionin tonë nuk kemi të punësuar ndonjë punonjës nga komunitetet tjera.

4.4.1 Nevojat për staf të rinj

ARKEP përkundër përgjegjësi të shtuara ka numrin me të vogël të zyrtarëve në rajon. Nevojat imediate për staf shtesë janë në këto pozitat:

1. Zyrtar për Infrastrukturë,
2. Zyrtar për radiomonitorim,
3. Zyrtar për Autorizime dhe mbikëqyrje të tregut në shërbimin postar,
4. Zyrtar për mbrojtje të drejtave të konsumatorëve,
5. Zyrtar inxhinieri softueri.

Paraqitja në formë tabelare e numrit dhe llojit të trajnimeve dhe nevojat për trajnime tjera

Duke pasur parasysh nevojën e vazhdueshme të ngritjes profesionale të zyrtarëve, gjatë viti 2024 mundësitë e mbajtjes së trajnimeve me prezencë dhe pjesëmarrje fizike kanë qenë shumë më të mira në krahasim me dy vitet paraprake. Sidoqoftë konferencat dhe organizimi i punëtorive profesionale përveç mbajtjes së tyre me prezencë fizike në shumë raste janë mbajtur edhe në mënyrë virtuale përmes platformave digjitale.

Duke qenë se ARKEP në vazhdimësi merr pjesë aktive në takimet e Trupit të Rregullatorëve Evropian për Komunikimet Elektronike (BEREC), si në nivelin teknik, ashtu edhe në atë të Bordit të Rregullatorëve, kjo praktikë ka vazhduar pa pengesa edhe gjatë periudhës raportuese, pra vitit 2024. Stafi profesional i ARKEP-it, aktualisht është i angazhuar në kuadër të dhjetë (10) Grupeve Punuese të ekspertëve të BEREC, të cilat janë listuar më poshtë:

Gjithashtu gjatë vitit 2024 janë organizuar edhe një numër trajnimesh, punëtorish e konferencash, ashtu siç janë listuar në tabelën më poshtë:

Tabela 3. Grupi punues në kuadër të BEREC, në të cilat stafi i ARKEP merr pjesë:

NR.	Emërtimi i punëtorisë, konferencave apo trajnimit.	Qëllimi dhe data	Organizatori dhe përfituesit
1	<i>Pjesëmarrja në Pounëtorinë e TAIEX sa i përket: “Cost reduction Directive”, Tiranë, Shqipëri.</i>	<i>6-7 Shkurt, 2024 Workshop-i është fokusuar në Direktivën BCRD, me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira në lidhje me rregulloren për reduktimin e kostove. Po ashtu janë paraqitur edhe përvorjat në zbatimin e GIA, i cili ka për qëllim të adresojë mangësitë e Direktivës për Reduktimin e Kostove të Bandwidth-it dhe të kontribuojë në vendosjen e rrjeteve të kapacitetit shumë të lartë (VHCN) në mënyrë të kostos efektive dhe të kohës për të përmbushur nevojat e rritura për lidhshmërinë e BE-së.</i>	<i>TAIEX, Tiranë, Shqipëri.</i>
2	<i>Spectrum Matters for 5G/6G & Wireless Connectivity for the Internet of Things (IoT)</i>	<i>Përfitime në njohurit profesionale ndërlidhur me kushtet e Autorizimit dhe përcaktimit të resurseve frekuencore duke ju referuar praktikave evropiane standardeve dhe rekomandimeve evropiane në</i>	<i>Org: LS telcom Training Academy - LS telcom AG -</i>



		teknologjitë e avancuar 5G dhe IoT si dhe zbatimin e Radio sistemeve në industri. Si mundë tu ofrohet Operatoreve me shume spektër për shërbime me kualitative dhe kuantitative ne zbatim te teknologjive ete reja 5G /6G. Ndërlidhja pa tela te IoT të njihen me teknologjitë më të fundit të radios në dispozicion për të fuqizuar aplikacionet IoT. Dallimet midis teknologjive, si dhe përfitimet dhe kompromiset e secilës nga teknologjit	77839 Lichtenau, Gjermani Përf.: ARKEP
3	Konference Rajonale - ITU-EKIP Regional Regulatory Forum for Europe 2024 Rregullatorëve nga rajoni dhe më gjërë, Budva	Konference Rajonale ne Budvë, Mal i Zi, 23 - 24 shtator 2024. Zgjerimi i njohurive në lidhje me zhvillimet dhe temat gjatë konferencës si në vijim. Trendet dhe zhvillimi i infrastrukturës dixhitale Strategjitë rregullatore për teknologjitë e reja të telekomunikacionit Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve Partneritetet publiko-private dhe kabllo të nëndetëse. Bashkëpunimi ndërmjet operatorëve celularë dhe satelitorë dhe përdorimi i përbashkët i brezeve frekuencore për të zgjeruar zonat e mbulimit etj	Org: EKIP Rregullatori nga Mali i Zi. Budve, Mal i Zi Përf.: ARKEP
4	Samiti 28 i Spektrit - LS telcom dhe konferenca e grupeve punese "USERgroup Conference"	- Shkrimi i SIM kartelës për një përdorues 5G" - Marrja e të dhënave të trafikut të një Stacioni bazë të teknologjisë 5G dhe analizimi i tyre".ligjërimet, demonstrit dhe ushtrime praktike për pjesëmarrësit.	Org: Qendrën e Inovacionit të Institutit NGN në Vitomiricë, Pejë Përf.: ARKEP
5	Trajnim Online "Using Spectrum: The Technical and Economic Aspects of Managing and Using Radio Spectrum	Trajnimi ka pas për qëllim ofrimin e një kuptim të thellë mbi menaxhimin dhe përdorimin e spektrit të radio frekuencave nga aspekti teknik dhe ekonomik. Trajnimi është mbajtur online përmes platformës Zoom nga periudha nga 02.12.2024 deri 13.02.2024.	Org: Center for Executive Education in Technology Policy (CEE-TP), College of Engineering (CIT) në Carnegie Mellon University (CMU). Përf.: ARKEP
6	Takimet PLENARE, Contact network (CN) dhe ato teknike të organizuara nga BEREC	Diskutimi dhe miratimi i dokumenteve të ndryshme teknike për zbatimin e kornizës rregullatore të komunikimeve elektronike të BE-së	Org: BEREC Përf.: ARKEP
7	5G today – market reality and market expectations	Maj 2024 Konference per rrjetet 5G	Org. Hansecom
8	Konferencë Vjetore për Rregullatorët/ IRC 2024	14 - 15 Maj 2024 - Ohgër, Maqedoni e Veriut	AEK Perfaqesues nga Bordi dhe Staf



9	TAIEX Multi Country Workshop on the transposition of the Digital Services Act (DSA)	<i>Qershor, 2024 Bruksel</i> Diskutimi i aspekteve të ndryshme të arkitekturës së Shërbimit Dixhital ACT (DSA), me një fokus të veçantë në masat për të rritur transparencën e platformave online në lidhje me politikat e tyre të moderimit të përmbajtjes, vlerësimin e rrezikut, masat zbutëse, rreziqet shoqërore të lidhura me shpërndarjen e përmbajtjeve të paligjshme, gjuhën e urrejtjes, dezinformimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore në shërbimet dixhitale.	TAIEX
10	Open Cyber Security Conference (OCSC) 2024	OCSC është një ngjarje unike për të festuar 30 vjet të bashkëpunimit ndërkombëtar të ekipeve evropiane të sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të incidenteve brenda një komuniteti vërtet global të praktikuesve të besuar. Konferenca ishte e fokusuar në të ardhmen e menaxhimit të incidenteve të sigurisë dhe si dhe adresimin e sfidave që vijnë. Tenerife, Spanje nga data 26 shkurt deri me 1 mars 2024	Organizuar nga FIRST/TF CSIRT/Open CSIRT dhe sponsorizuar nga eGA (E-Governance Academy) projekt regjional i BE-se për siguri kibernetike. KOS-CERT
11	Balkan Cybersecurity days: Conference and Technical Colloquium	Ngjarja është perbere nga pjesa e konferencës në ditën e parë dhe trajnime të ndryshme teknike për CERT-të Kombëtare të Ballkanit Perëndimor në ditën e dytë dhe të tretë. Ky kolokium teknik ishte i fokusuar në temën e ransomware, inteligjencës së kërcënimeve dhe tema të tjera të reja të sigurisë kibernetike. Durrës, Shqipëri 20-22 Mars 2024	Organizuar dhe sponsorizuar nga DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance KOS-CERT
12	EUISS/EU Cyber Direct "Workshop on Strengthening resilience to cyber-enabled hybrid operations in the Western Balkans"	Seminar që synoj adresimin e sfidave me të cilat ballafaqohet Ballkani Perëndimor në sigurinë kibernetike, manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit të huaj (FIMI) dhe kërcënimet hibride. Punëtorja u mblodh me diplomatë dhe ekspertë të sigurisë kibernetike nga Ballkani Perëndimor. Bruksel, Belgjike, 13 Shkurt 2024 : 13:30-18:00h	Organizuar dhe sponsorizuar nga European Union Institute for Security Studies KOS-CERT
13	Vizitë shkëmbyese në Tiranë ne AKCESK	Vizite me qëllim të diskutimit të temave që ndelidhen me organizimin të institucionit dhe përgjegjësitë, menaxhimi i incidenteve kibernetike. 13 Mars 2024, Tirane, Shqipëri	Organizuar dhe sponsorizuar nga DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance KOS-CERT
14	2024 CSIRT Technical Exchange and Training	15-18 Prill 2024, Berlin, Gjermani	Organizuar dhe sponsorizuar nga CERT® Coordination Center, Software Engineering Institute, Carnegie Mellon University



			KOS-CERT
15	2024 ISS World Europe	ISS World Europe synon të mbledhë ekspertë të industrisë së Zbatimit të Ligjit, Inteligjencës, Sigurisë Kombëtare, Krimin Financiar dhe Telekomit përgjegjës për hetimin e krimit kibernetik, mbikëqyrjen elektronike dhe mbledhjen e inteligjencës. 4-6 Qershor 2024, Prage, Republika Çeke	Organizuar nga ISS World dhe sponzorizuar projekti CoE/CYBERKOP, Keshilli i Evropës. KOS-CERT
16	Underground Economy Conference 2024	Ngjarja mbledhi rreth 500 ekspertë që përfaqësojnë agjencitë e zbatimit të ligjit, komunitetin e sigurisë kibernetike, profesionistë të industrisë private, shërbimet financiare dhe akademinë nga e gjithë bota duke ndjekur 4 ditë seminare ekskluzive dhe diskutime të rasteve. 2-5 Shtator 2024, Strasburg, France	Organizuar nga Keshilli i Evropës dhe Team Cumry, sponzorizuar nga projekti CyberSEE i Keshillit të Evropës KOS-CERT
17	International Visitor Lideship Program Titulli i programit: Promoting Cybersecurity	Ky projekt ilustron rëndësinë e sigurisë kibernetike për sigurinë ekonomike dhe kombëtare të SHBA-së, duke theksuar se si bëhen ligjet dhe politikat për sigurinë kibernetike dhe pse ato kërkojnë përditësime të vazhdueshme për të vazhduar me evolucionin teknologjik. Pjesëmarrësit do të eksplorojnë iniciativë që synojnë rritjen e koordinimit të sigurisë kibernetike midis agjencive qeveritare, sektorit privat dhe akademisë. Ata do të shqyrtojnë rolet dhe praktikatat më të mira të secilit sektor në parandalimin dhe rikuperimin nga sulmet kibernetike, edukimin e publikut dhe sigurimin që liritë civile të mos rrezikohen gjatë procesit. 21 Tetor – 8 Nëntor, 2024, SHBA	Organizara dhe sponzorizuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan. KOS-CERT
18	Competition law in the telecoms sector /online training course	17-19 November 2024 November 19th 2024, Pristina	Culleb International
19	Workshop on Inter-Party Parcel Delivery – Regulatory and Non-Regulatory Measures,	Prishtinë,	GIZ/CEFTA
20	TAIEX Workshop on Support for the Western Balkans to effectively implementation of Broadband Cost Reduction Directive and the European Electronic Communication Code	06-07.02.2024 in Tirana, Albania	Organizator: TAIEX Perfitues: DL/DKE/DMKI
21	Takimi përgatitor i Ekipit Negociator për raundin e tretë të negociatave ndërmjet Kosovës dhe EFTA-s	3-5 Qershor 2024 Gjenevë, Zvicër	Organizator: MINT Perfitues: DL
22	Mastering telecoms regulation - Online 2024 Edition	Online Qershor 2024	Cullen International

4.5 ASETET

Me qëllim të arritjes së objektivave dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, ARKEP posedon asete të ndryshme si sisteme harduerike/softuerike dhe asete të tjera të listuara si më poshte:

- Sistemi për menaxhimin e Brezit Frekuencor (*Spectraemc, SpectraPlus, SpectraMonitorPlus, SpectraPlan*);
- Aplikacioni për Notifikim dhe Aplikime Online;
- Sistemi për matjen e Kualitetit të Shërbimeve të Telefonisë mobile/fikse (QOS);
- Sistemi për Matje të Kualitetit të Shërbimeve të Internetit,
- Sistemi softuerik për matjen e trafikut të Internetit në nivel vendi (*IXP-Manager, Cacti*);
- Sistemi për menxhimin e incidentev dhe intelgjencës së kërcënimeve kibernetike (IRM-CTI) KOS - CERT;
- Sistemi për Faturim,
- Stacioni mobil i radio-monitorimit 2 (MMS);
- Stacioni transportues i radio-monitorimit 1 (TMS);
- Sistemi nacional i radio-monitorimit (SNMS), , stacionet Fikse Monitoruese: në Prishtinë (2), Prizren (1), Mitrovicë (1);
- Dron dhe pajisje portabile.
- Infrastruktura e TI-së, inventari dhe autoparku.

Planet për asetet e reja

Me qëllim të avancimit të ARKEP në Autoritet modern të operimit dhe komunikimit me palët e interesit, Autoriteti ka përfundur fazën e I-rë, të projektit "Digit-ARKEP - digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve, operimit dhe komunikimit të ARKEP". Ndërsa gjatë vitit në vijim do të vazhdoj me fazën e II, përkatësidht do të inicoj procedurat për realizimin e fazës II.

Faza I (*Digit Services*) përfshin digjitalizimin e shërbimeve të ofruara të ARKEP, për konsumatorët, operatorët, si dhe për palët e tjera të interesit, si publikun e gjerë vendim-marrësit dhe të tjerë akterë relevant në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.

Përditësimi i pajisjes 'Drive Test Tools' përfshirë pajisjet harduerike dhe softuerike me qëllim të mundësisë së monitorimit të brezeve frekuencore të alokuara për teknologjinë 5G.

ARKEP pothuajse që nga themelimi është i vendosur në objekt me qira për shkak të mungesës së hapësirave të veta apo në objekte publike. Në periudhën prej 17 viteve, përveç që ka shpenzuar shuma të konsiderueshme për shfrytëzimin e këtyre hapësirave, vazhdimisht është ballafaquar me mungesë të hapësirave të nevojshme të punës, këtë e ndërlikon më shumë fakti se këto hapësira nuk janë adekuate për vendosjen e sistemeve dhe pajisjeve të cilat i posedon ARKEP. Hapësira në të cilën aktualisht është e vendosur ARKEP është në një sipërfaqe prej 1470 m², dhe e njëjta nuk i plotëson të gjitha nevojat për funksionimin e mirëfilltë.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. Përshkrimi i shkurtë dhe një krahasim së paku me tre vitet e fundit

5.1.1 Autorizimet e Përgjithshme

Në përputhje me Rregulloren për Autorizimet e Përgjithshme, ARKEP edhe gjatë vitit 2024, ka vazhduar me dhënien e autorizimeve për ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

Regjistri i ndërmarrjeve të autorizuara është i publikuar në ueb faqen e Autoritetit dhe në baza të rregullta periodike përditësohet nga Autoriteti (<https://arkep-rks.org/Page/20>). I gjithë procesi i notifikimit është shumë i thjeshtë dhe realizohet përmes platformës online (<http://aplikime.arkep-rks.org/SQ>).

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e autorizimeve të përgjithshme të lëshuara nga Autoriteti ndaj ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2024, me përshkrimin e shërbimeve të autorizuara.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar gjithsej dhjetë (14) autorizime/konfirmime të njoftimeve për gjithsej tridhjetë e katër (34) aktivitete, të gjitha këto ndërmarrje të reja në tregun e komunikimeve elektronike.

Tabela 4. Regjistri i autorizimeve/Konfirmimeve të njoftimeve gjatë vitit 2024

AKTIVITET E NJOFTUARA GJATË VITIT 2024		
	Ofrimi i Shërbimeve me Vlerë të Shtuar (VAS)	2
	Ofrimi i Shërbimit të Internetit	8
	Ofrimi i Rrjet Publik fiks	8
	Ofrim i shërbimeve të linjave me qira	6

Deri në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në regjistrin e njoftimeve të ARKEP ka arritur në njëqind e tetëmdhjetë (118) me gjithsej dyqind e shtatëdhjet e dy (272) aktivitete të komunikimeve elektronike.

Ndërsa më poshtë është paraqitur numri i autorizimeve të lëshuara nga Autoriteti përgjatë viteve 2013 deri 2024:




Figura 1. Numri i autorizimeve të lëshuar nga Autoriteti gjatë viteve 2013 deri 2024

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 me kerkese të ndërmarrjeve janë revokuar shtatë (7) ndërmarrjeve Autorizimin për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

5.1.2 Implementimi i bartshmerise se numrave

Në vitin 2024, janë realizuar disa aktivitete të rëndësishme për implementimin e bartshmërisë së numrave:

- **Caktimi i numrave të rutimit**

Një nga hapat kryesorë për zbatimin e bartshmërisë së numrave ka qenë caktimi i numrave të rutimit për operatorët kryesorë të shërbimeve telekomunikuese në Kosovë, Telekom i Kosovës sh.a dhe IPKO.

- **Dhënia e Autorizimit për Bartshmërinë e Numrave për konsorciumin Botek shpk dhe PXS B.V.**

Në vitin 2024, është dhënë autorizimi për implementimin e bartshmërisë së numrave për konsorciumin Botek shpk dhe PXS B.V. Ky autorizim është një hap i rëndësishëm për realizimin e projektit, duke siguruar që proceset e bartjes së numrave të bëhen në mënyrë të sigurtë dhe efikase për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

- **Finalizimi i dokumentit “Kosovo Local (Mobile & Fixed) Number Portability Ordering Process Specifications (“LNP Business Rules”)**

Grupi Punues për Bartshmërinë e Numrave ka finalizuar dokumentin “Kosovo Local (Mobile & Fixed) Number Portability Ordering Process Specifications,” i cili përfshin rregullat dhe procedurat për bartshmërinë e numrave për shërbimet mobile dhe fikse. Ky dokument ka shërbyer si udhëzues për operatorët dhe për konsorciumin, duke siguruar që procesi të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të ofrojë një shërbim cilësor për konsumatorët.

- **Nënshkrimi i kontratës në mes operatorëve dhe PXS & Botek për implementimin e bartshmërisë së numrave,**

Një arritje tjetër e rëndësishme ka qenë nënshkrimi i kontratës në mes operatorëve Telekom I Kosovës dhe IPKO me konzorciumin PXS dhe Botek. Ky hap ka mundësuar fillimin e implementimit praktik të bartshmërisë së numrave, realizimin e testimeve, etj.

Me implementimin e projektit për bartshmërinë e numrave do të mundësohet:

- Rritja dhe ruajtja e konkurrencës në nivel shërbimi;
- Avansimi i metutjeshëm i të drejtave të konsumatoreve, pasi që do t'u ofrohet mundësia për ndrrimin e operatorit pa pasur nevojë për ndryshimin e numrit.

5.1.4 Pjesëmarrja në aktivitetet e BEREC-ut

Edhe gjatë vitit 2024, ARKEP ka marrë pjesë aktive në takimet e Entit të Rregullatorëve European për Komunikimet Elektronike (BEREC), si në nivelin teknik ashtu edhe në atë të Bordit të Rregullatorëve. Stafi profesional i ARKEP aktualisht merr pjesë në kuadër të dhjetë (10) Grupeve Punuese të ekspertëve në kuadër të BEREC-ut.

Tabela 5. Pjesëmarrje në grupet punuese BEREC

GRUPI PUNUES	AKTIVITETI
Fixed Network Evolution (FNE)	BEREC internal workshop on the migration to VHCN networks and copper switch-off with a focus on the needs of the end-users
	BEREC Report on competition amongst multiple operators of NGA-networks in the same geographical region (carry over)
Market and Economic Analysis (MEA)	BEREC Report on the regulatory treatment of business services (carry over)
Digital Markets (DM)	Report NI-ICS interoperability
Open Internet (OI)	Implementation of the Open Internet Regulation and the BEREC Open Internet Guidelines
End User (EU)	Report on comparison tools and accreditation (carry over)
	BEREC Opinion on Article 123 EECC
Regulatory Framework (RF)	BEREC Report on the authorisation and related framework for international connectivity infrastructures
	BEREC report on national experiences of the implementation of the EECC
Roaming (ROAM)	International roaming benchmark data and monitoring Report
	BEREC Input to the Commission on the Review of the Intra-EU Communications Regulation
Remedies and Markets Monitoring (RAMM)	BEREC Report on NRAs' annual reporting on the implementation of Article 75 of the EECC
	Calculation of Weighted Average Cost of Capital (WACC) parameters
Wireless Network Evolution (WNE)	Report on practices and challenges of the phasing out of 2G and 3G
	BEREC external workshop on secure and reliable connectivity in Europe from LEO satellite fleets
Planning and Future Trends (PFT)	Report on cloud services and edge computing

	Report on the impact of AI solutions in the telecommunications sector on regulation (carry-over)
	BEREC workshop on the perspectives and regulatory/competition challenges of Internet of Things
	Study on the trends and policy/regulatory challenges of cloudification, virtualisation and softwarisation in telecommunication
Cybersecurity (CS)	Support in reinforcing EU's Cybersecurity Capabilities
	Report on BEREC's activities to support initiatives for secure 5G networks

Po ashtu ARKEP raporton në mënyrë periodike indikatorët e tregut që kanë të bëjnë me:

- Roamingun dhe
- Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (FTR) dhe mobile (MTR), të cilat pastaj pas diskutimit në seancat e rregullta plenare publikohen në web faqen e BEREC-ut.

5.1.5 Menaxhimi i resurseve të fundme – Spektri frekuencor

Gjatë vitit 2024 janë realizuar dhe përgatitë njëqind e katërdhjetë e gjashtë (**146**) Autorizime Individuale të Radio frekuencave, të cilat shfrytëzojnë shërbime mobile tokësore PMR (*Private Mobile Radio*), shërbime mikrovalore (FIKSE), linqe PTP (*Point To Point*), shërbime satelitore dhe shërbime aeronautike.

Tabela 7. Numri total i autorizimeve dhe kanaleve sipas llojit të shërbimeve

LLOJI I SHERBIMIT	NUMRI I AUTORIZIMEVE	NUMRI I KANALEVE FREKUENCORE
PMR	108	324
FIKS	29	848
SATELITOR	4	4
AERONAUTIK	5	32
Numri total i autorizimeve	146	1208





Figura 2. Ndarja autorizimeve dhe kanaleve frekuencore sipas %

- ARKEP në gjysmën e dytë të viti 2024 ka shqyrtuar aplikacionet e operatorëve Telekom i Kosovës Sh.A, dhe IPKO Telecommunications LLC, të cilët kanë parashtruar kërkesë për shfrytëzim të resurseve frekuencore prej 2 x 20 MHz ne brezin 2100 MHz dhe një aplikacion nga Operatori IPKO për resurse frekuencore 2 x 10 MHz në brezin 700 MHz. Rritja e kapacitete frekuencore ne shfrytëzim në rrjetat e tyre MFCN kane ndikim te rëndësishëm në rritjen e kualitetit të shërbimeve të telefonisë mobile në vend e posaçërisht shfrytëzim i resurseve te brezit 700 MHz ndikon avancimin e zbatimit te teknologjisë 5G duke përfshirë edhe zonat rurale;
- Për shqyrtimin dhe zhvillimin e procesit sipas proceduarve te përcaktuara me legjislacion janë duke u zhvilluar nga komisioni profesionalë i përcaktuar nga ARKEP dhe pritet që gjatë vitit 2025 te finalizohet ky proces në përgatitjen dhe lëshimin e Autorizimeve te veqanta qe i jep të drejtën e shfrytëzimit te kapaciteteve frekuencore ne brezin 2100 MHz për të dy Operatorët Telekom i Kosovës SH.A dhe IPKO Telecommunications LLC.
- Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 694-790 MHz, për rrjetat e komunikimeve të lëvizshme & fikse (MFCN)", miratuar me Vendimin Nr. 2382 (nr. prot. 083/B/24) te ARKEP. Dokumenti përcakton planifikimin dhe shpërndarjen e shfrytëzimit te brezit të frekuencave 694 - 790 MHz ("brezi 700 MHz") për shërbimin e lëvizshëm të radio komunikimit, përcaktimin blloqeve dhe rangun e tyre ne kapacitetin e tërësishëm frekuencore prej 2x30 MHz, detajet e hollësishme teknike, mënyra e shfrytëzimit dhe qëllimit te shërbimeve mobile IMT/MFCN (Mobile/Fixed Communications Networks).
- Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit mes ARKEP dhe KPM përcaktuar ne paragraf se *"Në rrethana të favorshme për të dy Palët, ARKEP dhe KPM do të diskutojnë dhe ndërmarrin aktivitete për lirimin e brezit 700 MHz (694-790) dhe mundësitë e shfrytëzimit të këtij brezi për shërbime Mobile (IMT) të quajtur nga dokumente ndërkombëtare si Dividenta e dytë."* Ne këtë obligim te lirimit te brezit 700 MHz (694- 790 MHz) nga TV transmetuesit radio-difuzive, gjate viti 2024 janë mbajtur disa takime ndërmjet ARKEP, KPM dhe një takim se bashku me Operatorë - TV transmetuese Radio difuzive qe kane kanale frekuencore ne shfrytëzim ne brezin 700 MHz me qëllim te intensifikimit te aktivitetet te lirimit sa me te shpejt te brezit 700 MHz nga TV transmetuesit Radio difuziv dhe shfrytëzimin e kapaciteteve frekuencore te këtij brezi për shërbime mobile IMT /MFCN për operatorë ofrues te shërbime mobile te rrjetave publike MFCN.
- Harmonizuar për shfrytëzimin e spektrit frekuencor për qëllime Ushtarake dhe Civile është proces i vazhdueshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet ARKEP dhe KFOR. Si rezultat i këtij koordinimi janë dhënë nëntëmbëdhjetë (19) Autorizime Individuale me gjithsejtë gjashtëdhjetë e pesë (65) kanale frekuencore të brezit civil që do të përdoren për qëllim ushtarake nga KFOR. Gjithashtu është kërkuar dhe aprovuar nga KFOR-i përdorimi i i njëqind e njëzet e katër (124) kanaleve frekuencore te brezit ushtarak për qëllime civile.
- Është harmonizuar Plani i brendshëm kombëtar i Radio frekuencave ne shfrytëzim te resurseve frekuencore ndërmjet KFOR dhe ARKEP qe përcakton shfrytëzimit te brezave te

caktuar frekuencore për qëllime Civile që menaxhohen nga ARKEP dhe breze frekuencore në shfrytëzim për qëllime Ushtarake (Militare) dhe menaxhohen nga KFOR

5.1.6 Menaxhimi i Resurseve Numerike

Aktiviteti kryesor gjatë vitit 2024 ka qenë ndryshimi dhe plotësimi i rregullores për Planin e Numeracionit, ku disa nga ndryshimet kryesore janë: zvoglimi i tarifave vjetore për operatorët (shih tabelën në vijim), rritja e afatit kohorë për caktimin e resurseve numerike, Kodi 116 016 përdoret për linjën ndihmëse për viktimat e dhunës ndaj grave. Shërbimi u mundëson viktimave të dhunës ndaj grave të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje, të informohen për të drejtat e tyre dhe mënyrat për të kërkuar të drejtat e tyre dhe t'u referohen organizatave përkatëse, caktimi i formati të kodeve të rutimit, etj.

Tabela 8. Tarifat për Resurset Numerike të caktuara/rezervuara

	Gjeografik/Fiks dhe Nomadik (2x, 3x dhe 7x)	Mobil (4x) Dhe fikse	Shërbime të veçanta (8X)	Premium Rate (9x)	MNC	ISPC	VAS SMS (5X)	NSPC
Tarifat e deritashme	0.025 €	0.040 €	15 €	60 €	900 €	200 €	15 €	50 €
Tarifat e reja	0.015 €	0.015 €	15 €	50 €	500 €	200 €	15 €	50 €

Gjatë vitit 2024, sipas rekomandimeve të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) janë nxjerr mbi tetëdhjetë (80) vendime administrative për caktim e resurseve numerike, në varësi të llojit të shërbimit, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 6. Resurset Numerike të caktuara/rezervuara gjatë vitit 2024

SERIA	LLOJI I SHËRBIMIT	NUMRAT E KAKTUAR/REZERVUAR
1x	Kodet e shkurta për shërbime të interesit publik	2
2x/3x	Numeracioni Gjeografik – Telefonia Fikse	1,000
5x	Kodet e shkurta për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar	32
8x	Numeracioni jo gjeografik për shërbime të veçanta	83
9x	Numeracioni jo gjeografik për shërbime me çmim të lartë	3
EX1X2	Kode të rutimit	9
Totali i numrave të caktuar/rezervuar		1,129

Në ueb faqen e Autoritetit, linkun; <http://arkep-rks.org/?cid=1.50> mund të shkarkohet i gjithë regjistri i numeracionit të caktuar (ndarë), përkatësisht rezervuar nga Autoriteti deri në datën e azhurnimit (përditësimit) të saj.

Po ashtu, ARKEP me Vendimin Nr. 2392, i ka revokuar ndërmarrjes mts D.O.O. 5,000 numra në serinë e numeracionit gjeografik/telefonmia fikse, siç është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 7. Resurset Numerike të revokuara gjatë vitit 2024 (mts D.O.O.)

Seria (NDC)	Blloku	Fillimi i Bllokut	Fundi i Bllokut	Madhësia e Bllokut
(0)38	8x	810 00	829 99	2,000
		840 00	849 99	1,000
		860 00	869 99	1,000
		890 00	899 99	1,000
TOTAL				5,000

Kurse, me Vendimin Nr. 2304, ARKEP i ka revokuar ndërmarrjes Kujtesa Net, 21,000 numra në serinë e numeracionit gjeografik/telefonmia fikse, siç është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 11. Resurset Numerike të revokuara gjatë vitit 2024 (Kujtesa Net)

Prefiksi (NDC)	Fillimi i Bllokut	Fundi i Bllokut	Madhësia e Bllokut
(0)38	400 000	409 999	10,000
	410 000	413 999	4,000
(0)29	120 000	121 999	2,000
(0)39	130 000	130 999	1,000
(0)28	140 000	140 999	1,000
(0)390	150 000	150 999	1,000
(0)280	440 000	440 999	1,000
(0)290	170 000	170 999	1,000
GJITHSEJ:			21,000

Në figurat dhe tabelat në vijim është paraqitur numeracioni në dispozicion për rrjetet e telefonisë mobile dhe fikse.




Figura 5. Numeracioni në dispozicion për rrjetet mobile

Tabela12. Numeracioni i caktuar për rrjetet mobile sipas operatorit

Operatori	Numeracioni i caktuar (2x dhe 3x)	Përqindja sipas operatorit
Telekomi i Kosovës	2,800,000	50.18%
IPKO Telecommunications	2,420,000	43.37%
Dukagjini Telecommunications LLC	300,000	5.38%
Mts D.O.O.	60,000	1.08
TOTAL		100%




Figura 6. Numeracioni në dispozicion për rrjetet fikse

Tabela 13. Numeracioni i caktuar dhe në dispozicion për rrjetet fikse

Operatori	Numeracioni i caktuar (2x dhe 3x)	Përqindja sipas operatorit
Telekomi i Kosovës	387,000	67.78%
IPKO Telecommunications	100,000	17.51%
mts D.O.O.	84,000	14.71%
TOTAL	571,000	100%

5.1.7 Monitorimi i kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2024 ARKEP ka bërë monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve (QoS) të komunikimeve elektronike në tërë Kosovën për operatorët ofrues të këtyre shërbimeve në Kosovë, me theks operatorët Telekomi i Kosovës Sh.A. (tutje referuar si Telekomi/VALA) dhe IPKO Telecommunications LLC (tutje referuar si IPKO).

Duke pasur parasysh faktin se kohëve të fundit ARKEP ka vërejtur një degradim të kualitetit për parametra të caktuar të shërbimeve të komunikimeve elektronike, atëherë ARKEP ka vendosur vlerat minimale të parametrave të kualitetit, të cilat ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë të obliguar t'i zbatojnë:

- Koha e vendosjes së thirrjes (setup time) – koha mesatare për thirrjet kombëtare duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me 8 sekonda;
- Raporti i thirrjeve të pasuksesshme për thirrjet kombëtare duhet të jetë më i vogël ose i barabartë me 2%;
- Raporti i thirrjeve të ndërprera për thirrjet kombëtare duhet të jetë më i vogël ose i barabartë me 2%;
- Cilësia mesatare e lidhjes zanore duhet të jetë së paku 3 (PESQ-POLQA).
- Koha e përgjigjes për shërbimet e mbështetjes së klientit dhe mirëmbajtjes me telefon duhet të jetë më pak ose e barabartë me 5 minuta.

Po ashtu, ARKEP ka vendosur edhe obligime shtesë për operatorët sa i përket kualitetit të parametrave të qasjes në internet:

- Shpejtësia e garantuar/minimale (Shkarkimit/ngarkimit) në rastin e rrjeteve fikse duhet të jetë së paku 40% e shpejtësisë maksimale, e cila brenda periudhës dy vjeçare duhet të arrijë së paku 50% të shpejtësisë maksimale.
- Shpejtësia zakonisht në dispozicion (Shkarkim/Ngarkim) për rrjetet fikse duhet të jetë së paku 70% e shpejtësisë maksimale, respektivisht brenda periudhës dy vjeçare duhet të arrijë së paku 80% të shpejtësisë maksimale.
- Shpejtësia zakonisht në dispozicion në rastin e rrjetave fikse është shpejtësia që një parapagues duhet të arrijë së paku 80% të kohës gjatë ditës respektivisht brenda periudhës dy vjeçare të hyrjes në fuqi të Rregullores për Kontrata duhet të arrijë së paku 90% të kohës gjatë ditës.

Gjatë vitit 2024, monitorimi (Testimet) është realizuar për shërbimet, respektivisht parametrat si në vijim:

1. Shërbimi i qasjes mobile në internet (5G, 4G, 3G dhe 2G);

Parameterat:

- Shpejtësia mesatare në shkarkim (download);
- Shpejtësia mesatare në ngarkim (upload);
- Vonesa mesatare e paketave (delay/latency);
- Variacioni mesatar i vonesës së paketave (jitter);
- Shkalla e humbjes së paketave (packet loss ratio);

2. Shërbimi telefonik me zë/thirrjeve;

Parametrat:

- Koha mesatare e vendosjes së thirrjeve (call set-up time);
- Raporti i thirrjeve të pasuksesshme (Unsuccessful call ratio);
- Raporti i thirrjeve të rëna (Dropped call ratio);
- Kualiteti i transmetimit të zërit (Voice quality transmission) – standardi i vlerësimit PESQ dhe POLQA;

3. Shërbimi i operatorit (help-desk);

Parametrat:

- Koha e përgjigjes së operatorit.

ARKEP përdorë sistemet e saj për monitorimin e parametrave të kualitetit të këtyre shërbimeve të komunikimeve elektronike, respektivisht:

- Sistemin ARKEP Nettetest për monitorimin e kualitetit të shërbimeve të qasjes në internet;
- Sistemin VQT (Voice Quality Testing) për monitorimin e kualitetit të shërbimeve telefonike me zë/thirrjeve;

Sa i përket monitorimit të kualitetit të shërbimeve të qasjes mobile në internet, respektivisht të teknologjive mobile të saj 5G, 4G dhe 3G matjet realizohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke përfshirë qytetet, autostradat, rrugët magjistrale, rrugët lokale, etj.

Në figurën 7 dhe 8 janë paraqitur disa matje të kualitetit për operatorët VALA dhe PKO në lokacionin e njëjtë.




Figura 7. Rasti i një matjeve të operatoeve VALA dhe IPKO ne nje pike te caktuar




Figura 8. Rasti i një matje të realizuar për operatorët VALA dhe IPKO ne tere Kosoven

Në figurën 9 janë paraqitur disa matje të realizuara në qytetin e Prishtinës të realizuara nga ARKEP gjatë vitit 2024 për monitorim të kualitetit të shërbimeve të qasjes mobile në internet, respektivisht të teknologjive mobile të saj 5G, 4G dhe 3G që ofrohen nga operatori VALA.




Figura 9. Rutat e ndjekura në Prishtinë për matje gjatë vitit 2024 për monitorim të kualitetit të shërbimeve mobile të qasjes në internet për operatorin VALA (4G dhe 3G)

Ndërsa në vijim janë paraqitur numri i testimeve të realizuara përmes teknologjisë 5G, 4G dhe 3G dhe rezultatet për secilin parameter të shërbimit mobil të qasjes në internet për secilën teknologji.

Tabela 14. Rezultatet e matjeve të shërbimeve të qasjes mobile në internet - VALA⁶

Teknologjia	Numri i matjeve	Shpejtësia mesatare në shkarkim (download)	Shpejtësia mesatare në ngarkim (upload)	Vonesa mesatare e paketave (delay/latency)	Variacioni mesatar i vonesës së paketave (jitter)	Shkalla e humbjes së paketave (packet loss ratio)
5G	13	359.01Mbps	55.83Mbps	18.75ms	1.93ms	0%
4G	6427	55.87Mbps	26.78Mbps	25.31ms	3.23ms	4.36%
3G	14	15.49Mbps	3.09Mbps	58.60ms	13.51ms	8.29%

⁶ Sa i përket teknologjisë 5G, gjatë vitit 2024 operatori TK ka ofruar këtë shërbim vetëm për pajisjet IOS. Në anën tjetër sistemi i ARKEP aktualisht përdor vetëm pajisje që mbështesin sistemin operativ Android. Si rezultat, matjet për këtë teknologji të operatorit në fjalë janë të kufizuara dhe aktualisht mund të merren vetëm nga konsumatorët që përdorin pajisje të mbështetura, duke e bërë këtë një proces të bazuar kryesisht në vlerësimet dhe testimet e tyre.




Figura 10. Rutat e ndjekura për matje gjatë vitit 2024 për monitorim të kualitetit të shërbimeve mobile të qasjes në internet për operatorin IPKO (5G, 4G, 3G dhe 2G)

Ndërsa në tabelën 15 janë paraqitur numri i testeve të realizuara përmes teknologjisë 5G, 4G, dhe 3G si dhe rezultatet për secilin parameter të shërbimit mobil të qasjes në internet për secilën teknologji.

Tabela 15. Rezultatet e matjeve të shërbimeve të qasjes mobile në internet - IPKO

Teknologjia	Numri i matjeve	Shpejtësia mesatare në shkarkim (download)	Shpejtësia mesatare në ngarkim (upload)	Vonesa mesatare e paketave (delay/latency)	Variacioni mesatar i vonesës së paketave (jitter)	Shkalla e humbjes së paketave (packet loss ratio)
5G	2129	186.33Mbps	35.81Mbps	20.37ms	4.31ms	4.09%
4G	4037	37.67Mbps	20.00Mbps	25.83ms	4.35ms	5.74%
3G	275	5.83Mbps	1.89 Mbps	36.37ms	7.41ms	9.03%

Sa i përket kualitetit të shërbimeve telefonike me zë/thirrjeve të cilat ofrohen përmes telefonisë mobile të operatorëve mobil Telekom i Kosovës Sh.A./VALA (tutje referuar si VALA), IPKO Telecommunications (tutje referuar si IPKO mobile), gjatë vitit 2024 janë realizuar teste/matje në të paktën dhjetë (10) komuna në gjithë Kosovën nga ARKEP. Komunat e vizituara janë Prishtina, Prizreni, Ferizaji, Mitrovica, Podujeva, Peja, Gjakova, Lipjani, Gjilani dhe Kamenica.

Testimet janë realizuar në dy konfiguracione, brenda rrjetit (psh. VALA-VALA dhe IPKO mobile-IPKO mobile) dhe jashtë rrjetit (VALA-IPKO mobile dhe IPKO mobile-VALA).

Për ilustrim në vijim gjeni rezultatet e kualitetit të shërbimeve telefonike për konfiguracionet brenda rrjetit (VALA-VALA dhe IPKO mobile-IPKO mobile) dhe jashtë rrjetit (VALA-IPKO mobile dhe IPKO mobile-VALA).

Në tabelën 15, gjeni numrin e matjeve/testimeve të realizuara gjatë vitit 2024 përmes telefonisë mobile të operatorit VALA, si dhe rezultatet e matjeve për secilin parameter të shërbimit telefonik të zërit/thirrjeve në konfiguracionin brenda rrjetit (pra VALA-VALA).

Tabela 16. Testimet e realizuara përmes telefonisë mobile të operatorit Telekom i Kosovës/VALA – konfiguracioni brenda rrjetit

VALA – VALA (thirrjet brenda rrjetit)	
Paramteri	Vlera
Koha e vendosjes së thirrjes	< 6.83 sekonda
Përqindja e thirrjeve të pasuksesshme	< 0.06%
Përqindja e thirrjeve të rëna	< 0.69%
Kualiteti i zërit gjatë thirrjes	> 3.15 (nga 1-5)
Numri total i matjeve/testimeve	12.531

Në tabelën 16, gjeni numrin e matjeve/testimeve të realizuara gjatë vitit 2024 përmes telefonisë mobile të operatorit IPKO mobile, si dhe rezultatet e matjeve për secilin parameter të shërbimit telefonik të zërit/thirrjeve në konfiguracionin brenda rrjetit (pra IPKO mobile - IPKO mobile).

Tabela 17. Testimet e realizuara përmes telefonisë mobile të operatorit IPKO – konfiguracioni brenda rrjetit

IPKO mobile – IPKO mobile (thirrjet brenda rrjetit)	
Paramteri	Vlera
Koha e vendosjes së thirrjes	< 6.74 sekonda
Përqindja e thirrjeve të pasuksesshme	< 0.73%
Përqindja e thirrjeve të rëna	< 0.59%
Kualiteti i zërit gjatë thirrjes	> 3.00 (nga 1-5)
Numri total i matjeve/testimeve	13.396

Në tabelën 17, gjeni numrin e matjeve/testimeve të realizuara gjatë vitit 2024 përmes telefonisë mobile të operatorëve VALA dhe IPKO mobile në konfiguracionin jashtë rrjetit (pra VALA-IPKO mobile dhe IPKO mobile-VALA), si dhe rezultatet e matjeve për secilin parameter të shërbimit telefonik të zërit/thirrjeve.

Tabela 18. Testimet e realizuara përmes telefonisë mobile të operatorit VALA dhe IPKO – konfiguracioni jashtë rrjetit

Konfiguracioni i thirrjeve jashte rrjetit	VALA-IPKO mobile	IPKO mobile-VALA
<i>Paramteri</i>	<i>Vlera</i>	
Koha e vendosjes së thirrjes	< 6.33 sekonda	<8.74 sekonda
Përqindja e thirrjeve të pasuksesshme	< 0.30%	< 0.28%
Përqindja e thirrjeve të rëna	< 0.58%	< 0.20%
Kualiteti i zërit gjatë thirrjes	> 2.98 (nga 1-5)	> 2.98 (nga 1-5)
Numri total i matjeve/testimeve	6.958	6.785

Sa i përket kualitetit të shërbimit të operatorit (help-desk), si shërbim që ofrohet nga operatorët për konsumatorët e tyre për të ankimuar dhe zgjidhur problemet e tyre teknike dhe duke ofruar ndihmë teknike përmes thirrjes në linjat dhe numrat telefonik të operatorëve e të cilët numra janë në dispozicion për publikun, gjatë vitit 2024 ARKEP ka realizuar një numër të testimeve për operatorë të ndryshëm, ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike në Kosovë siç janë: Telekom i Kosovës Sh.A./VALA, IPKO Telecommunications LLC, Kujtesa.net, Art-Motion, Telkos, mts DOO, për të konstatuar kohen mesatare të përgjigjes së operatorit. Në vijim gjeni rezultatet e kualitetit për këtë shërbim.

Tabela 8. Testimet e realizuara të operatorit Telekom i Kosovës dhe IPKO

Operatori	Parametri	Vlera (në sekonda)	Numri i testimeve
Telekom i Kosovës Sh.A./VALA	Koha mesatare e përgjigjes së operatorit	20.88	217
IPKO Telecommunications LLC		63.15	220
Kujtesa.Net		65.23	215
Art-Motion		51.98	215
Telkos		27.60	220
Mts DOO		80.14	146

5.1.8 Analiza e tregjeve relevante, implementimi i detyrimeve rregullatore dhe mekanizmeve për sigurimin e konkurrencës efektive

ARKEP gjatë vitit 2024, ka mbikëqyrur në mënyrë efektive detyrimet e vëna për Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT), ka realizuar takime edhe me insitucione tjera lidhur me temat e konkurrencës dhe rregullimin e tregut.

- Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar këto dy analiza të tregjeve:
 - Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fiks;
 - Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet individuale mobile;

- ARKEP pas mbledhjes së të dhënave nga operatorët, ka bërë përpunimin e tyre dhe ka zhvilluar analizën e tregut konform Ligjit për komunikime elektronike, Rregullores nr. 54 analizat e tregut dhe direktiva relevante nga Komisioni Evropian.
- Gjatë definimit të tregut në tregun e terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fiks, rrjeti i secilit operator është definuar si treg i veçantë dhe rrjedhimisht, secili operator në rrjetin e vet është përcaktuar të jetë operator me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), e që janë Telekom i Kosovës, IPKO, Kujtesa dhe MTS.
- Gjithashtu edhe në tregun e terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet individuale mobile, rrjeti i secilit operator është definuar si treg i veçantë dhe rrjedhimisht, secili operator në rrjetin e vet është përcaktuar të jetë operator me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), e që janë Telekom i Kosovës, IPKO, dhe MTS.
- Secilit prej operatorëve në të dy tregjet u janë propozuar detyrimet në vijim:
 - Detyrimi për kontroll të çmimeve,
 - Detyrimi për ndarje të llogarive,
 - Detyrimi për qasje,
 - Detyrimi për transparencë,
 - Detyrimi për mos-diskriminim.
- Sa i përket detyrimit për kontroll të çmimeve, si një prej detyrimeve më të rëndësishme, ARKEP ka propozuar uljen e tarifave të terminimit dhe njëkohësisht reduktimin e përshkallëzuar gjatë 3 viteve të ardhshme me qëllim të përafrimit me tarifat e unfikuara në rrjetin mobil dhe fiks të vendeve të Bashkimit Evropian. Ulja e këtyre tarifave, që janë me shumicë mes operatorëve, synon të jetë si masë për nxitjen e uljes së tarifave me pakicë për konsumatorët fundorë.

Në pajtim me procedurat e përcaktuara me Rregulloren për mbledhjen e të dhënave statistikore periodike (Ref. Nr.Prot.04/B/11, e rishikuar në versionin më të ri me nr. protok. 070/B/23), ARKEP gjatë vitit 2024 ka publikuar gjithsej katër (4) raporte periodike në baza tremujore me indikatorët kryesor të tregut të komunikimeve elektronike, të cilat janë pubikuar në ueb faqen e ARKEP: <https://www.arkep-rks.org/Page/105>.

5.1.9 Mbrojtja e të drejtave të Konsumatorit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes operatorëve

Gjatë vitit 2024, ARKEP ka pranuar gjashtëqind e dymbëdhjetë (612) ankesa nga përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, ndër të cilat 396 ankesa për ofrimin e shërbimeve në pako të kombinuara (TV dhe internetit), 139 për shërbime të telefonisë mobile, 3 ankesa për Shërbime Postare dhe 74 për kualitetin e shërbimeve të internetit.

Deri në fund të vitit 2024 janë zgjidhur gjithsejtë 561 ankesa apo 92 % të ankesave të pranuar, prej tyre rreth 60% të bazuara, 27.5%, të pabazuara dhe 11.9% të refuzuara.




Figura 11. Statusi i ankesave të konsumatorëve




Figura 12. Numri i ankesave sipas kategorisë

ARKEP me Vendimin Nr. 2277 me datë 28.03.2024, ka themeluar Komisionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesve fundor/konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve. Ky komision ka për detyrë të bëjë shqyrtimin e kërkesave që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesve fundor dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në rastet kur përdoruesi fundor/Konsumatori është i pakënaqur me qëndrimin zyrtar të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Inspektimit.

Gjatë vitit 2024 Komisioni ka shqyrtuar gjashtë (6) ankesa ku ka dhënë rekomandimet e nevojshme për vendosje nga Bordi. Bordi i ARKEP me vendime ka vendosur lidhur me këto gjashtë (6) ankesa të përdoruesve fundor.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, përmes Komisionit për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet Ndërmarrësve, i formuar me Vendimin Nr. 2102.

Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve ka shqyrtuar ankesa që janë pranuar nga Operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike siç është IPKO dhe Telkos. Në vitin vijues, Komisioni pritet të jap rekomandimet për vendosje.

5.1.10 Monitorimi i spektrit radio frekuencor dhe Inspektimi

Departamenti i Monitorimit Radio Frekuencor (*shkurtë; DMRF*) me qëllim të përmbushjes së detyrave lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e shfrytëzimit të spektrit radio - frekuencor nga operatorët e autorizuar dhe në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike, në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2024, ka kryer monitorime në terren. Monitorimet janë realizuar me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kushteve të përgjithshme teknike si të përcaktuara me Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale për operatorët e autorizuar nga ARKEP.

DMRF, ka monitoruar brezet frekuencore të alokuara bazuar në Planin Kombëtar të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Radio Frekuencor dhe ka mbajtur të informuar në vazhdimësi Departamentin e Menaxhimit të Frekuencave lidhur me shfrytëzueshmërinë e këtyre brezeve.

Spektri radio frekuencor është një resurs i kufizuar natyror andaj përdorimi i tij në mënyrë efikase është me interes për vendin. ARKEP është Autoriteti kompetent për të menaxhuar dhe lehtësuar përdorimin efikas dhe të sigurt të spektrit radio frekuencor. ARKEP gjatë vitit 2024 ka përmbyllur procedurat për implementimin e projektit “Upgrade i Sistemit Drive Test Tools” përmes të cilit do të mundësohet edhe monitorimi i teknologjisë 5G.

Monitorimi i spektrit të frekuencave me anë të Stacioneve Fikse:

Gjatë vitit 2024, DMRF ka bërë monitorimin e spektrit radio frekuencor nga 20 - 8500 MHz, nga Qendra Kryesore e Monitorimit me ndihmën e Stacioneve Fikse Monitoruese të vendosura në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren. Po ashtu me ndihmën e Stacioneve Mobile, Transportuese dhe pajisjeve portabile është bërë monitorimi i spektrit radio frekuencor nga 9 kHz deri 40 GHz.

DMRF ka bërë:

- Monitorimin e operatoreve të autorizuar nga ARKEP për përdorim të resurseve frekuencore, si dhe respektim të përmbushjes së kushteve të përcaktuara me autorizime për shërbimet: Private Mobile Radio - PMR në brezin VHF dhe UHF.
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e përmbushjes së kushteve të autorizimeve individuale në brezin SHF të alokuar për linjat mikrovalore Pikë në Pikë (*Point to Point*);
- Matja e okupimit të kanaleve (FCO) dhe matjen e brezeve frekuencore (FBO);
- Monitorimin/Identifikimin e interferencave në rastet e paraqitjes së tyre apo njoftimit nga operatorët apo palet tjera.
- Monitorimin e depërtueshmërisë së sinjalit nga shtetet fqinje të brezet frekuencore që përdoren për teknologjitë GSM/UMTS/LTE.
- Shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga kompanitë e ndryshme vendore dhe ndërkombetare lidhur me vendosjen e Radio Pajisjeve në tregun e Kosovës, në përputhje me Rregulloren Teknike për Radio Pajisje.

Gjatë matjeve :

- Është bërë skanimi dhe inspektimi i plotë ifrastrukturës telekomunikuese në pjesën veriore të vendit tonë. Me ç'rast janë ndërmarr veprime konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi për operatorët e paautorizuar ku dhe janë konfiskuar radio pajisje.

- Është bërë verifikimi i përmbushjes së kushteve teknike si të përcaktuara me [Marrëveshje Teknike në mes të ARKEP të Republikës së Kosovës dhe AEK të Republikës së Magedonisë së Veriut për koordinimin kufitar të Sistemeve MFCN në brezet e frekuencave 800/ 900/1800/ 2100/ 2600 dhe 3600 MHz](#) si dhe është njoftuar Autoriteti homolog lidhur me gjetjet në teren.
- Janë monitoruar 11 operatorë për shërbime PMR në brezin frekuencor VHF/UHF, për mos përmbushje të kushteve të Autorizimeve, për të njejtë janë ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me ligjislacioni në fuqi për ndalimin respektivisht rregullimin e tyre.
- Është identifikuar dhe eliminuar me sukses ndërhyrja/interferenca e shkaktuar nga radio trasmetues FM në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në brezin frekuencor të Autorizuar për Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.
- Janë trajtuar nëntë raste të ndryshme për interferenca në breze frekuencor VHF/UHF dhe 900/ 1800 MHz të paraqitura sipas njoftimeve të pranuar në ARKEP

5.1.11 Veprimtaria e Njësive teknike KOS-IX dhe KOS-CERT

Nyja shkëmbyese e Internetit KOS-IX

Njësia KOS-IX është IXP e para e këtij lloji në Kosovë e cila është hapur më 23 Qershor 2011 nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*ish Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit - ART*) dhe është njësi funksionale brenda ARKEP dhe në kuptimin organizativ është neutral dhe jofitimprurëse.

Përparësitë e KOS-IX janë të shumta, e ndër me të rëndësishmet është avancimi i sigurisë dhe privatësisë së komunikimeve të Internetit duke e mbajtur trafikun vendor ‘lokal’ brenda kufijve kombëtar, dhe jo duke i lëshuar kufijtë e Kosovës siç ka qenë rasti para hyrjes në funksion të KOS-IX. Kjo e zvogëlon rrezikun përbërës që shfaqet gjatë dërgimit të të dhënave të ndjeshme përtej kufijve kombëtar dhe përmes shumë njejeve.

KOS-IX mundëson që të eliminon nevojën për të eksportuar trafik të brendshëm të internetit e që ndikon direkt në zvogëlimin e kostos dhe rritë cilësinë e shkëmbimit të trafikut në nivel kombëtar mes operatorëve.

Rregullorja Nr. 046/B/11 për Operimin e Njës Shkëmbyese të Internetit KOS-IX ka përcaktuar standardet teknike për qasje që operimin e Kos-IX, dhe gjithashtu vlen të theksohet se gjatë vitit 2024 është fituar edhe granti për modernizimin e KOSIX dhe avancimin e tij. Zyra e Kos-IX gjendet në objektin e Fakultetit Teknik përkatësisht Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Aktualisht janë pesë anëtare në KOS-IX, sikur janë listuar në tabelën në vijim, së bashku me kapacitetet e tyre përkatëse të shkëmbimit.

Tabela 20. Anëtarët e KOS-IX, Numrat Autonom dhe Kanalet komunikuese

OPERATORI	Numri Autonom (ASN)	Kanali Komunikues
Telekomi i Kosovës	AS206262	1 Gbps
IPKO	AS8661	10 Gbps
Kujtesa	AS33983	10 Gbps
Art Motion	AS29170	10 Gbps
TelKos	AS21246	10 Gbps

Për me tepër që nga viti 2012, KOS-IX është anëtare e rrjetit Euoprian të IXP-ve EUROIX.

Trafiku në KOSIX

Varësisht nga nevojat e operatorëve, KOS-IX ofron mundësi për kyçje me kapacitet prej 100Mbit/s; 1Gbit/s dhe 10 Gbit/s. Tarifat për lidhje në KOS-IX, janë ndarë në një tarifë për anëtarësim dhe një ose më shumë tarifa për porte.

Në figurën në vijim është dhënë trafiku maksimal i shprehur në Gbit/s për vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak 2023.




Figura 13. Trafiku maksimal i operatorëve për vitin 2023-2024

Nga grafiku më lartë shofim se gjatë vitin 2024 Telekomi i Kosovës, Kujtesa dhe Telkom kanë pasur një rritje të konsiderueshme të shkëmbimit të trafikut të Internetit në Kosovë, ndërsa gjithashtu edhe IPKO dhe ART MOTION kanë pasur një rritje për krahasim me vitin paraprak.

Statistikat totale nga viti 2024 sa i përket trafikut në KOSIX, krahasuar me vitin 2023.




Figura 14. Statistikat totale për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Në figurën e mësipërmë është e paraqitur trafiku total në TB i të gjithë operatorëve përgjatë vitit 2023 dhe krahasimi me vitin 2024. Nga grafiku i mësipërm shohim se të gjithë operatorët kanë pasur një rritje të konsiderueshme të shkëmbimit të trafikut të Internetit krahasuar me vitin paraprak.


Ndërprerja e Trafikut

Gjatë vitit 2024 në KOSIX nuk ka pasur asnjë ndërprerje të shkëmbimit të trafikut, pasi që kemi bërë monitorimin e trafikut 24/7, dhe nuk kemi lejuar që të këtë ndërprerje të paisjeve për matjen dhe shkëmbimin e trafikut të Internetit.


Si njësi përgjegjëse për monitorimin e trafikut të internetit të shkëmbyer mes operatorëve në Kos-IX, i kemi të gjitha kontaktet për rastet emergjente në të cilat jemi të gatshëm të ofrojmë ndihmë 24/7.

Në figurat e mëposhtme shihet se nuk ka pasur asnjëherë ndërprerje të theksuar, për asnjërin nga operatorët e që këto të dhëna janë të gjeneruara nga IXP Manager rreth MRTG: KOSIX/FIEK / Errors / Year:


Art Motion




Ipko



Kujtesa Net



Telekomi I Kosovës



Telkos




Figura 15. Trafiku i qarkulluar në KOSIX sipas operatorëve

Njësia nacionale për siguri kibernetike KOS-CERT

Fokusi i njësisë KOS-CERT ka qenë i orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave dhe planifikimeve të referuara në planin vjetor të performacës për vitin 2024, dhe konform kësaj ka kryer shërbimet dhe aktivitetet si në vijim:

- Shërbimi i ngritjes së vetëdijes për publikun e gjerë dhe nevojat specifike të konstituentëve ku janë bërë dy (2) postime me paralajmërime të sigurisë në rrjetin social facebook, deri sa shërbimi i publikimit të buletineve të sigurisë për shkak të resurseve të kufizuara nuk ka mundë

të kryhet, për tu fokusuar më shumë në dhënien e rekomandimeve dhe udhëzimeve teknike në lidhje me veprimet/masat e sigursie që nevojiten ti aplikojnë palët;

- Analizimi dhe dhenja e kërkesave për bllokim të domeneve më qëllime të këqija pas raportimeve nga palët relevante. Domenet me qëllim të keq kanë qenë kryesisht të orientuara me qëllim të mashtrimit të përdoruesve të e-Kosova dhe bankave kryesore që operojnë në Kosovë.
- Në vazhdimësi është bërë dokumentimi dhe menaxhimi i dobësive në infrastrukturën e ndryshme në Republikën e Kosovës sipas numrave autonom, bazuar në të dhënat që posedojmë, ku palët janë njoftuar në lidhje me këto kërcënime potenciale. Gjithsej 17 njoftime dhe paralajmërime të sigurisë janë dërguar te palët.
- Janë pergaditur 2 analiza të kercnimit dhe janë dërguar te palët;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e projekteve me karakter regional dhe me gjere të implementuara nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare me qëllim të ngritjes dhe avancimit te sigurisë kibernetike në Republikën e Kosovës
- Pjesëmarrja ne grupin punuese më qëllim të hartimit të legjislacionit sekondarë që derivon nga Ligji për Siguri Kibernetike si dhe kontributi në rishikimin dhe dhenjen e propozimeve në lidhje me Rregullorjen mbi sigurinë dhe funksionimin e duhur të rrjetave dhe/ose shërbimeve te KE;
- Përfaqësimi në Grupet Punuese për Siguri Kibernetike për Infrastruktura Kritike me ftesë nga Zyra Kryeministrit dhe USAID, ku gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 3 takime;

5.1.12 Indikatorët e tregut të komunikimeve elektronike

Tregu i komunikimeve elektronike në Kosovë vazhdon të shënoj trende pozitive në disa segmente të tij, siç është rritja e të hyrave nga shërbimet mobile dhe të internetit.

Evidencat e ARKEP, këtë vit tregojnë për ulje të numrit të përdoruesve të telefonisë mobile, e cila përshkruhet me zvogëlim në vëllimin e përdorimit të rrjetit të rregullt me zë dhe SMS, ndërsa me rritje të shfrytëzimit të shërbimeve të përdorimit brezgjërë. Në fund të vitit 2024 , numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur shifrën prej 1,936,000 që krahasuar me fundvitin e kaluar, shënon një ulje prej -0.30%.

Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në vitin 2024 në segmentin e telefonisë mobile është 120.81 % krahasuar me 107 % në vitin e kaluar. Numri i përdoruesve me qasje brezgjërë (broadband) 3G dhe 4G në pajisjet mobile të mençura (smartphone) në 2024 ka arritur shifrën prej 1,613,223 që është 0.9% më shumë se viti i kaluar.

Në shërbimet e ofruara nga rrjetet fikse, qasja brezgjërë në internet fiks në fund të 2024 ka arritur në 393,075 përdorues, që është 1.92% më i lartë se vitin e kaluar dhe normë e penetrimit për ekonomi familjare është rreth 107.4%. Përndryshe rreth 60 % të ekonomive familjare shfrytëzojnë qasje në internet fiks brezgjërë me shpejtësi së paku 100 Mbps, që është më e mirë se në shumë shtete anëtare të BE-së.

Pasi që brezi frekuencor është resurs primar në ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, në vazhdim në mënyrë më të përmbledhur do të pasqyrojmë indikatorët kryesor të këtij tregu.

5.1.13 Tregu i Telefonisë Mobile

Shërbimet e telefonisë mobile në Kosovë ofrohen nga dy operatorë të rrjetave të telefonisë mobile në brezin frekuencor 900/1800 MHz si dhe operatori me autorizim të përkohshëm dhe me infrastrukturë të kufizuar mts D.O.O.;

- Telekom i Kosovës Sh.a
- IPKO Telecommunications LLC
- mts D.O.O., Autorizim i përkohshëm dhe me infrastrukturë të kufizuar.

Krahas dy operatorëve të autorizuar të rrjetave MNO (*Mobile Network Operator*), aktualisht ekziston një operator mobil virtual (MVNO) ⁷, Dukagjini Telecommunications Sh.a. (*D3mobile*), i cili ofron shërbime M2M.

5.1.13.1 Përdoruesit dhe penetrimi i telefonisë mobile

Penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile në këtë vit ka shënuar ngritje të lehtë në krahasim me fundin e vitit të kaluar për 12.96 %. Penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile tani është në nivelin 120.81 %, të numrit të popullsisë.

Ngjashëm me parapaguesit e telefonisë mobile edhe parapaguesit e shërbimeve të internetit mobil, që nga lansimi i këtyre shërbimeve vazhdon të tregoj trend të rritjes. Duhet theksuar se që nga muaji dhjetor 2016 deri në fund të vitit 2024 numri i përdoruesve aktivë të cilët janë qasur në internet mobil dhe gjatë asaj kohe kanë qenë të lidhur me rrjetin 3G /4G dhe 5G në vazhdimësi është rritur.

Në vijim është dhënë figura e numrit të parapaguesve të shërbimeve të telefonisë mobile dhe shërbimeve mobile të internetit (MBB).




Figura 16. Parapaguesit e shërbimeve të telefonisë mobile dhe shërbimeve mobile BB 2016-2024

⁷ Operatori IPKO Telecommunications LLC ka marrëveshje komerciale me d3 Mobile.

Krahas rritjes së numrit dhe vëllimit të përdorimit të trafikut të shërbimeve të komunikimeve elektronike, ka një trend të ringritjes së të ardhurave mesatare për njësi në telefoninë mobile (ARPU), të cilat në tremujorin e fundit të vitit 2024 janë 5.4 €, krahasuar me vlerën 5.1 €, në vitin paraprak. Ka një transferim gjithnjë e më të madh të shprehisë së klientëve nga komunikimi përmes rrjetit të rregullt të telefonisë mobile në komunikimin përmes rrjetit mobil brezgjërë.




Figura 17. Penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile dhe shërbimeve mobile BB 2017-2024

Që nga viti 2021, ekziston një trend gjithnjë e në rritje i përdorimit të të dhënave nga shërbimet mobile brezgjera, sikur që mund të shihet në figurën në vijim përgjatë viteve 2017-2024, ku vetëm në vitin e fundit (2024) ka një rritje prej 31 % të vëllimit të trafikut të të dhënave nga viti paraprak. Analizuar konsumin për klientë, më 2024 një klient ka harxhuar mesatarisht 43.41 GB në vit.




Figura 18. Trafiku i të dhënave në rrjetin mobil brezgjërë

5.1.13.2 Mbulueshmëria

Aktualisht, sipas deklarimeve të operatorëve mbulueshmëria sa i përket shërbimeve të teknologjisë GSM ka arritur pothuajse 100 % të popullsisë në nivel vendi dhe rreth 98 %, sa i përket territorit. Krahas teknologjisë GSM, me liberalizimin e brezit që nga viti 2013 operatorët në vazhdimësi kanë investuar në rritjen e mbulueshmërisë për ofrimin e shërbimeve mobile brezgjëra në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, të njohura ndryshe si 3G, 4G dhe 5G.




Figura 19. Mbulueshmëria e operatorëve mobil Telekomi i Kosovës dhe IPKO

5.1.13.3 Përdorimi i shërbimeve 'roaming' në Ballkanin Perëndimor nga kosovarët

Zbatimi i marrëveshjes regjionale të 'roaming' në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) dhe reduktimi i tarifave është duke ndikuar që numri i përdoruesve të shërbimeve 'roaming' të rritet gjithnjë e më shumë. Figura në vijim, jep detaje rreth numrit të përdoruesve në shërbimet 'roaming' dhe përqindjes ë këtyre përdoruesve nga numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në Kosovë.




Figura 20. Përdorimi i shërbimeve 'roaming' në numra absolutë dhe relativë

Ndërsa në vijim paraqitet përdorimi i internetit të qytetarëve të Kosovës në shërbimet 'roaming' në Ballkanin Perëndimor për periudhën TM4 2023 – TM3 2024. Si të dhënat për numrin e përdoruesve, ashtu edhe ato për përdorimin e internetit tregojnë një nivel të lartë për tremujorin e tretë të vitit. Madje vetëm në TM3 përdoret internet 'roaming' më shumë se në tre TM-të marrë si total. Kjo vjen

si rezultat i pushimeve verore që realizojnë kosovarët jashtë vendit, posaçërisht në bregdetin e Shqipërisë.




Figura 21. Përdorimi i internetit 'roaming' nga kosovarët në Ballkanin Perëndimor

Të hyrat e operatorëve

Në tabelën më poshtë janë paraqitur të hyrat e tregut dhe të hyrat mesatare për përdorues në tregun e telefonisë mobile në Republikën e Kosovës.

Tabela 21. Të hyrat e përgjithshme në tregun e telefonisë mobile dhe ARPU

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Të hyrat (mln. €)	187.4	170.8	140.4	121.5	111.5	108.0	109	90.8	76.3	92.5	102.5	118.23	124.47
Mesatrrja e ARPU (€)	9.5	8.8	6.8	5.7	4.6	4.4	4.6	3.2	3.6	4.6	4.85	5.10	5.4

*Shënim: Në këto llogaritje nuk janë përfshirë ARPU për komunikimet e tipit M2M.

Telefonia Fikse

Shërbimet telefonike fikse në Kosovë ofrohen nga katër (4) operatorë të cilët ofrojnë shërbime bazuar në infrastrukturën vetanake.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga operatorët për vitin 2024, rezulton se numri i përdoruesve të telefonisë fikse gjendet në nivelin prej 68,759 mijë linja aktive, që paraqet rritje rreth 1.76% në raport me vitin 2023. Norma e penetrimit të telefonisë fikse është 4.3% .

Figura në vijim paraqet numrin e parapaguesve dhe penetrimin e telefonisë fikse ndër vitet e fundit.




Figura 22. Parapaguesit dhe penetrimi i telefonisë fikse (2017 – 2024)

Ndarja e përdoruesve të telefonisë fikse në individual dhe të biznesit është paraqitur në figurat e mëposhtme. Nga të dhënat në figurë mund të vërehet se parapaguesit e biznesit përbëjnë pjesën më të madhe prej 68 % të strukturës së parapaguesve të telefonisë fikse, dhe trendi është që përdoruesit individualë gjithnjë e më pak do të përdorinë telefoninë fikse.




Figura 23. Struktura e parapaguesve të telefoni fikse

Qasja brezgjere në internet rrjeti fiks

Qasja brezgjere në internet ofrohet nga rreth pesëdhjetë (50) ndërmarrje të autorizuar, gjashtë (6) prej tyre kanë qasje të drejtpërdrejtë në daljet ndërkombëtare 'International Gateway', të cilat ofrojnë qasje në internet për ISP-të, më të vogla, e që veprojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Si në vitet tjera edhe gjatë vitit 2024, shërbimet brez-gjera 'broadband' të Internetit për ekonomie familjare dhe për biznese vazhdojnë të kenë rritje të numrit të përdoruesve. Në vijim është paraqitur trendi i përdoruesve për të dy kategoritë.




Figura 24. Numri i përdoruesve të internetit fiks për ekonomi familjare dhe biznese 2016 – 2024

Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të vitit 2024, të raportuara nga operatorët, penetrimi i qasjes në internet brezëgjërë me bazë ekonomitë familjare është afërsisht 99.8%. Në bazë të regjestrimit të fundit të popullsisë të publikuar në dhjetor të vitit të kaluar na del që janë regjistruar me shumë ekonomi familjare të cilat janë të pabanueshme dhe rrjedhimisht edhe përqindja në vitin 2024 na është zvogeluar.

Në figuren në vijim është paraqitur ecuria e numrit të përdoruesve dhe penetrimi i shërbimeve brezgjera për ekonomie familjare përmes rrjeteve fikse.




Figura 25. Penetrimi i shërbimeve të qasjes fikse të internetit për ekonomi familjare 2016– 2024




Figura 26. Ndarja e tregut (në %) të internetit sipas përdoruesve për operator

Teknologjitë e përdorura

Teknologjia kryesore për ofrimin e qasjes në internet në rrjete fikse edhe gjatë vitit 2024 është përmes modemit kabllor (kabllo DOCSIS) e cila vazhdon të dominojë në treg me rreth 68% e pasuar nga teknologjia FTTH e cila ka shënuar një rritje të mirë, gjersa qasja përmes teknologjisë xDSL edhe këtë vit është në mesataren e njëjte 4.6%.

Teknologjia pa tela 'wireless' kryesisht përdoret në zonat të thella rurale, ku shfrytëzohen brezet e pa-liçensuara frekuencore 2.5 GHz dhe 5 GHz.




Figura 27. Shpërndarja e linjave të internetit sipas teknologjisë së rrjetit të qasjes

Nga të dhënat në figurë vërehet se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve brez-gjera u ofrohet përdoruesve nga operatorët përmes kombinimit të kabllor koaksial dhe fibrës. Një ndryshim cilësor vërehet trendi në rritje të ofrimit të shërbimeve të qasjes në internet përmes fibrës optike FTTH duke përdorur teknologjinë GPON.

Si ofrues kryesor të shërbimit të internetit përmes kabllor koaksial janë: IPKO, KujtesaNET dhe ARTmotion, ndërsa operatorët të cilët ofrojnë qasjen në internet për përdoruesit fundor kryesisht përmes teknologjisë xDSL janë Telekom i Kosovës dhe operatori mts d.o.o. Gjatë vitit 2024 kanë vazhduar ndryshimet cilësore në ofrimin e qasjes brez-gjere në Internet, ku pjesa dërmuese e operatorëve kanë vazhduar rritjen kapacitetit të ofrimit të qasjes në internet.

5.1.17 Tregu i shërbimeve postare

Sa i përket tregut të shërbimeve postare për tre vitet e fundit rezultojnë se në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, kemi një rënie të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën - 3.92 %, ndërsa krahasuar me vitin 2022, rezultojnë se kemi një rritje të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën 7.95%.

Nga numri i përgjithshëm i dërgesave postare, rreth 52.50 %, janë letër dërgesa postare, ndërsa rreth 47.50 % janë dërgesa të pako/kolipostës ose pako postare. Nga numri i përgjithshëm i dërgesave

rreth; 84.30 % e dërgesave postare janë të pranuar dhe shpërndara në trafikun e brendshëm, pra janë postë vendore, ndërsa rreth 15.70 % janë postë ndërkombëtare.

Numri i dërgesave postare për vitet 2022 deri 2024 është paraqitur në figurat në vijmi.




Figura 27. Numri i dërgesave postare 2022 – 2024

5.1.18 Realizimi i planit të prokurimit

Aktivitet kryesor të realizuara nga zyra e prokurimit gjatë vitit 2024 janë:

- Përgatitja e planifikimit përfundimtar të planit të prokurimit për vitin 2024;
- Inicimi dhe publikimi i aktivitete të prokurimit të planifikuara për vitin 2024;
- Janë nënshkruar njëzet e katër (24) Kontrata nga procedurat e inicuar gjatë vitit 2024,
- Dy (2) aktivitete në proces të pa përfunduara që kane mbetur në fund të vitit;
- Pesë (5) Aktivitete të pa inicuar gjatë vitit 2024 *(nuk janë inicuar nga njesitë kërkuese)*;
- Është realizuar lëshimi i 94 urdhërblereve për realizimin e pagesave.

5.2 PLANET PËR VITIN VIJUES

5.2.1 Departamenti i Komunikimeve Elektronike

- Implementimi i bartshmërisë së numrave në rrjetet mobile dhe fikse, si njëri nga mekanizmat kryesor për mbrojtje të konkurrencës.
- Hartimi i planit për zbatimin e Ligjit për uljen e kostos së shtrirjes së rrjetave të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.
- Koordinimi i aktiviteteve me institucionet komunale dhe qendrore për shtrirjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
- Organizimi i takimeve të përbashkëta me Institucionet Qendrore dhe Komunale për koordinimin e aktiviteteve për shtrirjen e infrastrukturës.
- Zbatimi i dokumentit “Roadmap” për uljen e tarifave të roamingut në mes WB6 dhe BE,
- Pjesëmarrja aktive në draftimin e ligjit të ri për komunikime elektronike, i cili e transponon Kodin e Komunikimeve Elektronike të BE-së

- Krijimi i kornizës rregullatore për zbatimin e Rekomandimeve të BE-së për sigurinë e rrjetave 5G (5G Security Toolbox).
- Monitorimi i parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me rregulloren e re;
- Krijimi i kornizës rregullatore për trajtimin e pajisjeve të prodhuesve me rrezikshmëri të lartë (High risk vendor- Untrusted vendor).
- Koordinimi i aktiviteteve me institucionet relevante lidhur me zbatimin e numrave për shërbimet sociale të interesit publik të ofruara nga Institucionet publike (Seria 116 xxx e numeracionit).
- Zbatimi i Agjendës digjitale për Kosovës 2030;
- Mbikëqyrja e përfundimit të implementimit të kodit telefonik.
- Analizimi i raporteve të CEPT/ECC, BEREC si dhe praktikave të Rregullatorëve europian lidhur me: rolin e numrave E.164 në mashtrimin (fraud); ndërkombëtar dhe/ose keqpërdorimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike; dhe zbatimin e M2M.

5.2.2 Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave

- Avancimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i spektrit frekuencor
- Funksionaliteti dhe Operacionalizimi i menaxhimit të spektrit frekuencor
- Përcjellja e trendëve evropiane në fushën e radio komunikimeve
- Bashkëpunimi dhe koordinimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për Radio frekuenca
- Dhënia në shfrytëzim e brezeve për shërbimeve Mobile – IMT dhe IMT 2020
- Marrëveshjet teknike për Harmonizimin e shfrytëzimit të frekuencave në zonat kufitare

5.2.3 Departamenti i Radio Monitorimit dhe Inspektimit

- Mbikëqyrja e kushteve teknike të përcaktuara në Autorizime Individuale;
- Monitorimi /Identifikimi i interferencave dhe i përdorimit të paautorizuar të spektrit Radio Frekuencor;
- Rritja e efektivitetit të Radio Monitorimit;
- Mbikëqyrja e zbatimit të Rregullores Teknike për Radio pajisje;
- Përgatitja e ToR për avancimin e pajisjes 'Drive Test Tools', me qëllim të monitorimit edhe të teknologjisë 5G.

5.2.5 Departamenti i Rregullimit Ekonomik dhe Tregut

- Avancimi i kornizës rregullative për shërbime postare;
 - Rregullorja për shërbimet e shpërndarjes së paketave ndërkufitare;
 - Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut të shërbimeve postare;
- Publikimi i të dhënave statistikore mbi tregun e shërbimeve postare;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes operatoreve dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve të shërbimeve postare.

5.2.6 Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve dhe Inspektimit

- Rritja e transparencës, vetëdijesimi, mbikëqyrja për të siguruar mbrojtën aktive të të drejtave të konsumatorëve në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare;
- Mbikëqyrja e aktivitetet e ndërmarrjeve, të cilët ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike dhe postare, për kontrollin e zbatimit të Kornizës Rregullatore dhe kushteve të përcaktuara nga ARKEP;
- Aktivitete për ngritjen e vetëdijes së konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre përmes materialeve të shkruara/broshura apo përmes videove
- Publikimi i të dhënave statistikore ne raport me ankesat e pranuar;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes operatorëve dhe konsumatorëve, trajtimi i ankesave të konsumatorëve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.
- Avancimi i platformës për krahasimin e ofertave të pakove të operatorëve në përputhje me kërkesat e Rregullores për kontrata, transparencë, publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike në kuadër të platformës Digit ARKEP

5.2.7 Divizioni i Teknologjisë së Informacionit

Divizioni i Teknologjisë së Informacionit ka realizuar një sërë projektsh kyçe gjatë vitit 2024, me fokus në avancimin dhe modernizimin e infrastrukturës teknologjike dhe shërbimeve të ofruara. Gjatë këtij viti, Autoriteti ka përmbytur qëllimin e digjitalizimit të proceseve të brendshme, ka avancuar shërbimet e ofruara për palët e interesuara dhe ka përmirësuar sigurinë e rrjetit dhe sistemet kompjuterike. Po ashtu, ka pasur një fokus të veçantë në sigurinë e rrjetit dhe menaxhimin e Nyjes Shkëmbyese të Internetit (IXP).

▪ Zhvillimi i Platformës për Aplikime Online (DIGIT-ARKEP)

Një nga projektet kryesore ka qenë implementimi i projektit Digit-ARKEP, që ka mundësuar digjitalizimin e proceseve të brendshme dhe zhvillimin e një platforme për aplikime online Faza II. Ky projekt ka mundësuar që shërbimet e ARKEP për konsumatorët, operatorët dhe palët e interesuara të bëhen më të aksesueshme dhe efikase, duke lehtësuar ndërveprimin dhe menaxhimin e proceseve administrative dhe operacionale të Autoritetit.

▪ Zhvillimi i Sistemit iCloud (Virtualizimi i Sistemeve Kompjuterike)

Një tjetër projekt i rëndësishëm ka qenë zhvillimi i sistemit iCloud, i cili ka për qëllim virtualizimin e sistemeve kompjuterike dhe krijimin e një infrastrukture më fleksibile dhe të disponueshme për rrjetin e komunikimit dhe replikimin e të dhënave dhe shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Ky sistem ka ofruar më shumë disponueshmëri dhe fleksibilitet për sistemet e brendshme kompjuterike të Autoritetit, duke përmirësuar efikasitetin operativ dhe sigurinë e të dhënave.

▪ Siguria e Rrjetit të Autoritetit dhe Menaxhimi i Nyjes Shkëmbyese të Internetit (IXP)

Një prioritet i madh ka qenë përmirësimi i sigurisë së rrjetit të Autoritetit dhe menaxhimi i Nyjes Shkëmbyese të Internetit (IXP). Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka realizuar një sërë masash për rritjen e sigurisë kibernetike, duke përfshirë forcimin e mbrojtjes nga sulmet e mundshme dhe monitorimin e trafikut të rrjetit për të parandaluar veprimet e paautorizuara. Siguria e rrjetit ka qenë esenciale për të siguruar që informacionet dhe shërbimet e Autoritetit të mbeten të mbrojtura dhe të

disponueshme pa ndërprerje. Për këtë qëllim, janë aplikuar teknologji dhe praktika të avancuara për mbrojtjen nga sulmet kibernetike, përfshirë mbrojtjen e njave kritike dhe përdorimin e sistemeve të avancuara për mbikëqyrje dhe detektimin e kërcënimeve në kohë reale. Menaxhimi i Nyjes Shkëmbyese të Internetit ka qenë një tjetër hap kyç për përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e efikasitetit të rrjetit. Ky sistem ka mundësuar lidhjen direkte dhe të shpejtë midis operatorëve të ndryshëm të internetit dhe ka mundësuar shkëmbimin efikas të të dhënave, duke përmirësuar performancën dhe sigurinë e rrjetit të internetit të Autoritetit.

▪ **Avancimi i Shërbimeve të IT-së dhe KOSIX**

Një tjetër projekt i rëndësishëm ka përfshirë zhvillimin dhe përditësimin e shërbimeve të IT-së dhe të sistemit KOSIX. Ky projekt ka mundësuar përmirësimin e sistemeve harduerike dhe softuerike dhe ka ofruar një mundësi për menaxhimin më efikas të burimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, duke rritur performancën dhe sigurinë e shërbimeve.

▪ **Modernizimi i Infrastrukturës Harduerike dhe Softuerike**

Për të mbështetur zhvillimet teknologjike, janë realizuar projekte të ndryshme për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printereve me qira, si dhe për furnizimin dhe servisimin e sistemeve të videovëzhgimit. Këto projekte kanë ndihmuar në rritjen e sigurisë, përmirësimin e efikasitetit dhe mbështetjen e një mjedisi të sigurt për punonjësit dhe aktivitete të tjera të Autoritetit.

▪ **Siguria dhe Mbrojtja e Infrastrukturës Fizike dhe Teknologjike**

Pjesë e angazhimeve të vitit 2024 ka qenë gjithashtu servisimi i sistemeve të alarmit, përfshirë sistemet kundërzjarrit dhe alarmet e vjedhjes. Kjo ka mundësuar përmirësimin e sigurisë fizike të infrastrukturës dhe ka garantuar që pajisjet dhe informacionet e ndjeshme të mbeten të mbrojtura nga çdo kërcënim i mundshëm.

▪ **Aktivitetet Administrative dhe Mirëmbajtja e Sistemeve**

Një tjetër aktivitet ka përfshirë mirëmbajtjen e ueb faqes, vazhdimin e domainit dhe hostingut, si dhe organizimin e ngjarjeve të rëndësishme, si organizimi i 20-vjetorit të Autoritetit. Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e komunikimit me palët e interesuara dhe rritjen e transparencës në aktivitetet e Autoritetit.

▪ **Furnizimet dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve**

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit ka përfshirë furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit (TI) dhe furnizimin me klimë, bateri dhe pajisje të tjera mbështetëse, si dhe servisimin dhe mirëmbajtjen e kondicionerëve për të siguruar kushte optimale për ambientet e punës dhe operacionet e përditshme. Në përgjithësi, vitin 2024 ka shënuar një vit të suksesshëm për Divizionin e Teknologjisë së Informacionit në Autoritet, duke avancuar dhe modernizuar infrastrukturën teknologjike dhe shërbimet e ofruara. Fokusimi në sigurinë e rrjetit dhe në menaxhimin e Nyjes Shkëmbyese të Internetit ka siguruar një mbrojtje të fuqishme për të dhënat dhe sistemet e Autoritetit, duke garantuar disponueshmëri të lartë dhe një komunikim të sigurt me palët e interesuara. Këto përpjekje kanë kontribuar në përmirësimin e efikasitetit operativ dhe në rritjen e besueshmërisë të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.

5.2.8 Njësia nacionale për reagime kibernetike KOS-CERT

KOS-CERT do të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve në koordinimin e përpjekjeve për reagim duke identifikuar kërcënimet dhe dobësitë në rrjetet dhe shërbimet e konstituenteve, si dhe duke informuar publikun e gjerë për rreziqet potenciale që vijnë nga hapësira kibernetike.

Fokusi po ashtu do të orientohet në bashkëpunim më të gjithë aktetë relevant ndërkombëtar dhe vendorë me qëllim të ngritjes dhe avancimit të sigurisë kibernetike si në aspektin ligjor po ashtu edhe në atë operacional.

Kontributi nga njësia KOS-CERT do të fokusohet në pjesëmarrjen në grupet e ndryshme punuese vendore duke përfshirë Grupin punues për Siguri kibernetike për infrastrukture kritike, draftimin e legjislacionit sekondare në fushën e sigurisë kibernetike si dhe kontributin për themelimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike.

Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike aktualisht është njësi funksionale brenda Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), e themeluar në vitin 2016 bazuar në Nenin 10, Paragrafin 21 të ligjit për Komunikime Elektronike, tashme i shfuqizuar nga Ligji për Siguri Kibernetike ku parashihet që të formohet Agjencia për Siguri Kibernetike dhe KOS-CERT të operoj brenda saj. KOS-CERT do operoj brenda ARKEP deri në formimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike.

Fokusi i njësive KOS-CERT gjatë vitit 2025 do të orientohet kryesisht në objektivat si vijon:

- Ngritja e vetëdijes për publikun e gjerë;
- Monitorimi i kërcënimeve dhe dobësive dhe dhënia e rekomandimeve për nevojat specifike të konstituenteve;
- Pjesëmarrja në Grupet Punuese për Siguri Kibernetike për Infrastruktura Kritike;
- Realizimi i aktiviteteve sipas nevojës për themelimin e Agjencisë për Siguri Kibernetike;
- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në aktivitetet e projekteve që implemenetohen me qëllim të ngritjes dhe avancimit të sigurisë kibernetike në Republikën e Kosovës;

5.2.9 Departamenti i Financave dhe shërbimeve të përgjithshme

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme është përgjegjës për Udhëheqjen dhe menaxhimin e Financave dhe punëve administrative, duke siguruar që funksionet dhe detyrat e caktuara të kryhen brenda afateve kohore.

Në bashkëpunim me Departamentet dhe njësitë brenda ARKEP planifikon dhe propozon buxhetin dhe resurset njerëzorë, përkujdeset dhe mbikëqyr procedurat për zbatimin e dispozitave të akteve të aplikueshme për menaxhimin e personelit, përgatitjen e konkurseve për rekrutimin e stafit sipas legjislacionit në fuqi, përgatitjen e akt emërimeve, vendimeve të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave të ARKEP-it, zbaton të gjitha politikat dhe procedurat Administrative të nevojshme për të siguruar mbështetjen Financiare dhe administrative për Departamentet dhe njësitë funksionale në ARKEP në përbushje të aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara.

5.2.10 Njesia e prokurimit

Ne mbështetje të planifikimit përfundimtar të prokurimit do të iniciohen dhe të realizohen të gjitha procedurat e prokurimit për aktivitetet e prokurimit të planifikuara në vitin 2025 sipas kërkeave dhe nevojave të njësive kërkuese .

Në vazhdimësi do të bëhet mbikëqyra e aktiviteteve të prokurimit sipas legjislacionit në fuqi, këshillimi dhe mbikëqyrja e kontratave gjatë realizimit si dhe kompletimi i lendeve dhe procedimi për pagese në Njësine e Financave.

5.3 VEPRIMET QË KA NDËRMARRË INSTITUCIONI QË TË PËRMIRËSOHET/MONITOROHET TREGU/FUSHA E VEPRIMIT

- Janë nxjerrë disa akte nënligjore, siç janë nxjerrja e Rregulloreve të reja dhe/ose plotësim ndryshimi i rregulloreve tjera dhe udhëzuesit të ndryshëm në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, dhe një numër i konsiderueshëm i vendimeve të cilat kanë ndikim në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare;
- Është kryer analiza e dy tregjeve: tregu i qasjes në nivel lokal me shumicë të ofruar në lokacion fiks (3a) dhe tregu i qasjes në nivel qendror me shumicë, i ofruar në lokacion fiks për produktet e tregut masiv (3b),
- Eshtë përfunduar projekti Digit-ARKEP, i cili ka për qëllim digjitalizimin e shërbimeve të ofruara të ARKEP për konsumatorët, operatorët, si dhe për palët e tjera të interesit, si publikun e gjerë, vendim-marrësit dhe të tjerë aktorë relevant në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.
- Është miratuar Rregullorja e reviduar për bartshmërinë e numrave e cila merr parasysh zhvillimet e fundit teknologjike dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, në aspektin e implementimit. Me këtë projekt synohet rritja e konkurrencës në treg duke iu mundësuar konsumatorëve ruajtjen e numrit gjatë ndërrimit të ofruesve të shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.
- Monitorimi i përmbushjes së obligimeve të operatorëve me marrëveshjen e romingut regjionale WB6.
- Inspektimet specifike në terren për monitorimin e përmbushjes së obligimeve të operatorëve në përputhje me autorizimet e përgjithshme dhe individuale.
- Mbikëqyrje në mënyrë efektive e detyrimeve të vëna për operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT) dhe janë mbajtur takime edhe me insitucione tjera lidhur me temat e konkurrencës dhe rregullimit të tregut.
- Pjesëmarrje e vazhdueshme e stafit në trajnime, punëtori e konferenca me qëllim të ngritjes profesionale dhe ndjekjes së zhvillimeve dhe trendeve të reja në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

5.4 SFIDAT E VITIT PARAPRAK

- Për shkak të dinamikës së lartë dhe kostove relativisht të larta të teknologjisë së re, ARKEP duhet të parashikojë më tepër fonde për digjitalizimin dhe blerjen e pajisjeve të TI-së, për nevoja të Autoritetit. Këto fonde duhet të parashikojnë jo vetëm koston e blerjes së teknologjisë, por në të njëjtën kohë dhe kostot për të mbuluar nevojat e zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare. Konkretisht, këto fonde do të duhen edhe për trajnimin e stafit, si dhe mbështetjen për zyrtare, të cilët do të duhej të familjarizohen me teknologjinë e re.
- Gjatë implementimit të projektit SNMS sfidë kanë qenë vonesat e paraqitura nga Institucionet përgjegjëse për tu pajisur me leje përkatëse për vendosjen e SNSM në lokacionet ku ishin përcaktuar dhe plotësonin kriteret e ITU për vendosjen e Stacioneve Fikse Monitoruese në vendin tonë. Me marrjen e pëlqimeve janë ngritur katës (4) SNSM në lokacionet: Prishtinë - Zllatar, Prizren - Parku ITP, Mitrovicë-Lushtë, si dhe është bërë frunizimi me një Stacion Mobil Monitorues (*Mobile Monitoring Station-MMS*) dhe Transportues (*Transportable Monitoring Station-TMS*).

6. REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizës rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2024, është ballafaquar me sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë:

- **Mungesa e pavarësisë financiare** - Pavarësia financiare është kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Evropian në raportet e progresit për Kosovën, përfshirë raportin e fundit të publikuar gjatë vitit 2023, si dhe BEREC; rekomandim i dhënë edhe përmes raportit të Auditimit të brendshëm (*Ref Dokumenti „Raporti final i auditimit të brendshëm Nr. Prot; 104/2/25,dt;28.03.2025*).
- **Ngritja e kapaciteteve profesionale**, me fokus të veçantë ruajtja dhe rritja e resurseve profesionale/nëpunësve të ARKEP. Në veqanti, pagat për disa profile mbeten të ulëta dhe të pa krahasueshme me pagat e sektorit, të cilin ARKEP e rregullon. ARKEP vlerëson lartë Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për klasifikimin e disa pozitave të zyrtarëve të profilit inxhinier në kategorinë ekspert, që ka mundësuar krijimin e kushteve më të favorshme të punës për zyrtarët në fjalë. Megjithatë, marrë parasysh faktin se në ARKEP pothuajse asnjë aktivitet rregullator nuk zhvillohet dhe përmbyllet pa angazhimin edhe të profesioneve tjera si ekonomist dhe jurist, atëherë është kruciale dhe çështje urgjente që të gjendet një zgjidhje edhe për këta zyrtarë;
- **Lirimi i brezit 700 MHz**, Për shkak të mos implementimit të Ligjit të digjitalizimit procesi liritimit të brezit 700 MHz është shtyrë. ARKEP ka intensifikuar aktivitetet me KPM në plan tjetër si mundësi e zhvendosjes së operatorëve TV transmetues Radio difuziv nga brezi 700 MHz në brezin me të ulët 470 – 694 MHz në harmonizim me Vendimet dhe rekomandimet Evropiane të CEPT/ECC të përcaktuar në ‘Planin Kombëtar për Radio frekuenca’ e ku parashikohet që brezi 700 MHz të lirohet nga shërbimet Radio difuzive të filloj shfrytëzimi i tij për shërbime Mobile në rrjetet MFCN si brez i përshtatshëm në zbatimin e teknologjisë 5G;
- **Vështirësitë dhe barrierat në rekrutim të stafit** si pasoje e procedurave nga legjislacioni në fuqi;
- **Koordinimi i frekuencave ndërkufitare me Serbinë**, ku si rezultat i mos-nënshkrimit të marrveshjes teknike valët nga operatorët mobil të Serbisë depërtojnë thell në brendësi të territorit të Republikës së Kosovës duke shkakëtuar interferenca;
- **Rritja e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike**;
- **Plotesim ndryshimi i nenit 28 të ligjit Ligjit Nr. 06/L-038 për shërbimet postare** nga MPB me Ligjin Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (*GZ / Nr.16/6 Korrik 2023, Prishtinë*) i cili ka shkaktuar vështirësi në raportimet financiare të operatoreve postar dhe aplikimin a tarifës së mbikqyrje së tregut.

- **Anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare** dhe marrja e domenit të internetit (ccTLD) për shkak të pengesave politike.

6.1 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KONFORM LIGJIT

Detyrat dhe përgjigjësit e Autoritetit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike (*LKE*), Ligjin Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare (*LSHP*), si dhe Ligjin Nr. 08/L – 007, për Masat për Uljen e Kostos së Shtirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë.

Autoriteti ushtron funksionet në përputhje me ligjet dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.

6.2 QËLLIMET E ARRITURA NGA VITI PARAPRAK

Viti 2024 ka qenë mjaftë i suksesshëm për faktin se janë arritur të përmbushen shumë nga objektivat strategjike të përcaktuara në planin e punës. Në vijim në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur arritjet e ARKEP për vitin 2024:

- I. Përgaditja dhe Miratimi i “*Plani i Përdorimit të Radio frekuencave*” (Nr. Prot. 008/B/25 dt: , Vendimin nr. 2418 Nr. Prot. 007/B/25) të ARKEP. Ky plan është hartuar në përputhje me Planin Kombëtar të Radio Frekuencave (PKRF),
- II. Fuqizimin e mëtutjeshëm të drejtave të konsumatorëve (*Konsumatori në qendër*), përmes vendosjes së obligimeve shtesë për operatorët, rritjes së transparencës, dhe krijimit të kushteve më të përshtatshme për konsumatorët;
- III. Hartimi i dokumenteve të nevojshme për bartshmërinë e numrave në rrjetet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike, dhe është zgjedhur operatori për implementimin e këtij projekti.
- IV. Përgaditja dhe Miratimi i Plani i shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit të frekuencave 694 - 790 MHz për rrjetat e komunikimeve të lëvizshme & fikse (MFCN)” Vendimit Nr. 2382 dt. 25/10/2024 (Ref. Nr. Proto. 083/B/24).
- V. Dhënja e resurseve frekuencore për rrjetet private 5G në nivel lokal/rrjet i mbyllur jo komercial. Gjatë viti 2024 ARKEP ka lëshura dy Autorizim të reja për shfrytëzimit të resurseve frekuencore në brezet 3710- 3800 MHz, në rrjetat Lokale për qelime të hulumtimeve, inovacioneve dhe trajnimeve në zhvillimin e teknologjisë 5G.
- VI. Hartimi i Rregulloreve të reja të parapara në planin e punës, si Rregullorja për Brezet Frekuencore dhe Kushtet Teknike për Shfrytëzimin e Pajisjeve për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual i Radio Frekuencave,

- VII. Janë rritur kapacitetet për monitorimin e parametrave të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përputhje me udhëzimet e BEREC-ut.
- VIII. Janë realizuar inspektime të ndryshme të operatorëve për verifikimin e përmbushjes së obligimeve rregullatorë, dhe lidhur me gjetjet operatorët janë udhëzuar për marrjen e hapave për adresimin e tyre.
- IX. Ka filluar analiza e tregjeve të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike;

Gjithsesi, në referim të përmbushjes së obligimeve për transparencë, vlen të theksohet se në mungesë të resurseve njerëzore dhe profesionale, edhe gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vazhduar të përballet me sfidën administrative, ndërlidhur me obligimin për publikimin e dokumenteve edhe në gjuhën serbe dhe atë angleze.

Ndër aktivitetet që janë në proces dhe nuk kanë arritur të finalizohen janë:

- Implentimi i procesit të bartshërisë së numrave, për shkak të ngecjeve në procesin e prokurimit, si dhe mospërfundimit të procesit të implementimit të kodeve nga ana e operatorëve të telefonise mobile;
- Përgatitje e dokumentit për Planin e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të brezit 24.25 – 27.5 GHz për shërbime mobile – rrejtja MFCN në zbatimin e teknologjive të avancuar (**5G**) në nivel Nacional dhe Lokal. Shtyrja e realizimit Planifikimit shkakë i harmonizimit me KFOR për lirim të brezit nga shfrytëzimi për qëllime militare në Civile arritur në dhjetor të vitit 2024 dhe mos interesimi i operatorëve për shfrytëzim të këtij brezi për shërbime mobile IMT si brez i ri i përcaktuar nga rekomandimet evropiane në aplikim për shërbime mobile IMT. Planifikimi i këtij brezi do të realizohet në vitin 2025.
- Anëtarësimi në organizata ndërkombetare për shkaqe kryesisht të natyrës politike;
- Mos adresimi i disa aktiviteteve të cilat nuk kanë patur ndikim substancial në treg, për shkak të mungesës së resurseve njerëzore.
- Çështja e koordinimit të aktiviteteve lidhur me shtrirjen e infrastrukturës – Me gjithë progresin e bere gjatë vitit 2024 ku janë realizuar takime me palët e interesit si ofruesit e shërbimeve të rrjetave fikse (ISP), ndërmarrjet e infrastrukturave tjera si KEDS, megjithatë kjo objektive nuk është përmbushur plotësisht.

7. RAPORTI FINANCIAR

7.1 RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti financohet nga Buxheti i Kosovës përmes të hyrat të Autoritetit, në pajtim me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Kreu XII, neni 83, përkatësisht nga pagesat lidhur me veprimtarinë e Autoritetit si;

- pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;
- pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave;
- Pagesat për caktimin e numrave dhe serive numerike;
- Pagesat nga sanksionet ekonomike; dhe
- Çdo pagesë tjetër të paraparë me aktet e aplikueshme (*tarifat rregullative*) që mblidhen nga operatorët e licencuar që operojnë në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.

7.1.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura nga Autoritetit janë krijuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Komunikime Elektronike, Ligjit për Shërbime Postare dhe Rregulloreve financiare në fuqi depozitohen në llogarinë zyrtare të Autoritetit të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në BQK.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka planifikuar të hyra në vlerën 7,486,490.00 Euro, ndërsa shuma e të hyrave të realizuar është 5,065,207.18 Euro, apo shprehur në përqindje rreth 67.66 %, në raportin me planifikimin final të cilat janë prezantuar sipas tabelës në vijim:

Tabela 22. Raporti i të Hyrave – 2024

#	Të hyrat	Planifikimi	Realizimi nga planifikimi	% e realizimi ne raport me planifikim
		A	B	D=B/A*100
1	Pagesa Vjetore për Mbikëqyrjen e Tregut të Komunikimeve elektronike	800,000.00	794,237.91	
2	Pagesa Vjetore për Mbikëqyrjen e Tregut të shërbimeve Postare	50,000.00	1,610.07	
3	Pagesat Vjetore për caktim/shfrytëzim të Radio Frekuencave	2,000,000.00	2,237,908.58	
4	Pagesa Vjetore për caktim/shfrytëzim të Numeracionit	250,000.00	249,192.5	
5	Gjitha Pagesat Tjera (Taxat Administrative,gjobat,qendra KOSIX,radio amatorët etj)	12,000.00	85,634.23	
6	Pagesë e njëhershme për Autorizime Individuale (one of fee)	4,374,490.00	1,696,623.89	
Totali		7,486,490.00 €	5,065,207.18 €	67.66%

Arsyeja e realizimit të buxhetit në nivel me të ulet së planifikimi është ndryshimi i ligjit Nr. 06/L-038 për shërbime postare, përkatësisht neni 28 i ligjit, shtyerja e procesit të dhenies së brezit 2100 MHz proces i cili është shtyr për arsye procedurale si dhe percaktimi i „Grace” periudhes për pagesat e autorizimeve individuale të brezeve të reja frekuencore në funksion të zhvillimit të tregut dhe nxitjes së investimeve.

7.1.2. Realizimi i Buxhetit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me Ligjin Nr. 08/L-260, për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, ka miratuar buxhetin e Autoritetit në lartësi prej; 1,546,894.00Euro, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në tabelën e paraqitur si në vijim;

Tabela 23. Buxheti i Autoritetit i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës

PËRSHKRIMI	BUXHETI
Paga dhe mëditje	457,145€
Mallra dhe shërbime	471,549 €
Shpenzime komunale	18,200 €
Shpenzime kapitale	600,000 €

Buxheti i ARKEP ka pësuar ndryshime konform procedurave të rregullta Ligjore:

1. Vendim i Qeveris Nr.prot. 03/239 dt: 24.12.2024 shtim i mjeteve te kategoria e pagave në vlerë prej 1726.33euro

me çka edhe buxheti final i alokuar brenda sistemit SIMFK ishte në lartësi prej; **1,548,620.33 Euro**, i ndarë sipas kategorive paraqitet si në vijim;

Tabela 24. Buxheti final në SIMFK

PËRSHKRIMI	BUXHETI
Paga dhe mëditje	458,871€
Mallra dhe shërbime	471,549 €
Shpenzime komunale	18,200 €
Shpenzime kapitale	600,000 €

Shkalla e realizimit të buxhetit prej 66.47 % në raportin me buxhetin e alokuar është një indikator i cili tregon nevojën imediate dhe arsyen e ndryshimit të Ligjit të Komunikimeve Elektronike dhe Ligjit të prokurimit pasi që pavarësi financiare e Autoritetit dhe realizimi i procedurave të prokurimit nga Autoriteti janë ndikuesit kryesor në planifikimin dhe realizimin e Buxhetit në nivel të duhur.

Tabela 25. Realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike

PËRSHKRIMI	REALIZIMI
Paga dhe mëditje	458,348.32€
Mallra dhe shërbime	443,762.36€
Shpenzime komunale	16,674.36€
Shpenzime kapitale	109,360.00€

7.2 ADRESIMI I GJETJEVE TË AUDITORIT NGA VITET PARAPRAKE

Raporti i Auditimit për vitin 2023 për ARKEP-it, nga Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka patur ndonjë gjetje apo rekomandim për ARKEP. (Ref. Raporti i Zyres së Auditorit të Përgjithshëm për ARKEP Nr. 159/2/2024 datë 11.06.2025).

Ueb faqja e ARKEP:

[file:///C:/Users/nazim.rahimi/Downloads/Raporti%20i%20auditimit%20p%C3%ABr%20Pasqyrat%20%20Financiare%20Vjetore%20T%C3%AB%20ARKEP%20p%C3%ABr%20vitin%202023%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/nazim.rahimi/Downloads/Raporti%20i%20auditimit%20p%C3%ABr%20Pasqyrat%20%20Financiare%20Vjetore%20T%C3%AB%20ARKEP%20p%C3%ABr%20vitin%202023%20(2).pdf)

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare më datë; 20.06.2025 ka pranuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të ARKEP për vitin 2024. (Ref. Raporti i ZKA, Nr.Pr. 205/2/25 datë 20.06.2025).

Zyra Kombëtare e Auditimit, në Raportin e Auditimit të ARKEP-it për vitin 2024, ka dhënë opinionin të pamodifikuar dhe atë si në vijim:

“Opinion i pamodifikuar” për pasqyrat financiare vjetore

‘Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024’.

Baza për opinion

‘Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA- së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion’.

Konkluzion për pajtueshmërinë

‘Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ARKEP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare’.



9. SHTOJCA

Legjislacioni në fuqi dhe Aktet nënligjore të nxjerra gjatë 2024

Nr.	Emërtimi i Dokumentit	Nr.Ref	Data
Legjislacioni Primar/Ligjet			
1	Ligji për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë	08/L-007	19 Nëntor 2021
2	Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike	05/L-030	28 Maj 2015
3	Ligji për Komunikimet Elektronike	04/L-109	04 Tetor 2012
4	Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike	04/L-094	15 Mars 2012
5	Ligji për Shërbimet Postare	06/L-038	17 Janar 2019
Politikat/Strategjitë			
1	Agjenda Digjitale e Kosovës 2030	//	Maj 2023
Legjislacioni Sekondar/Rregulloret			
1	Rregullorja nr. 61 për kontratat, transparencën, publikim e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundor të shërbimeve të KE-së	Nr. Prot. 005/B/24	6 Shkurt 2024
2	Rregullorja nr. 62 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.50 për Planin e Numeracionit	Nr. Prot. 014/B/24	28 Mars 2024
3	Rregullorja Nr. 63 - për Monitorimin e Parametrave të Kualitetit të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike	Nr. Prot. 019/B/24	02 Prill 2024
4	Rregullore Nr.64 për Dhënien e Autorizimit Individual për Radio Stacionet e Mjetit Ajror	Nr.Prot. 040/B/24	28 Maj 2024
5	Rregullorja nr. 65 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.62 për Planin e Numeracionit	Nr. Prot. 051/B/23	02 Korrik 2024
6	Rregullorja Nr.66 për Brezet Frekuencore dhe Kushtet Teknike për Shfrytëzimin e Pajisjeve për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual i Radio Frekuencave	Nr.Proto. 012/B/24	10 Janar 2024



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE